

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5509
E hënë, 25 qershor 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi: Nga marrëveshja përfundimtare përfitojnë të dy vendet

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pas takimit me homologun e vet serb, Aleksandar Vučić, ka treguar se janë pajtuar që procesi i dialogut të rritet në javët e ardhshme. Sipas tij, arritja e marrëveshjes përfundimtare është në interes të dy vendeve dhe rajonit ■ FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI KLINAKU ■ FAQE 4-5

Qeveria aktuale s'ka ndryshime prej qeverive të kaluara



Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkimin (LB), Avni Klinaku, ka vlerësuar se Kosova aktualisht ka një gjendje jo të mirë dhe një perspektivë të zymtë. Ai ka thënë se në vazhdimësi kemi pasur qeveri që nuk janë përkujdesur për interesin

e qytetarit dhe të vendit. Po ashtu, rolin e opozitës e ka vlerësuar të zbehtë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klinaku ka deklaruar se Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë keq sa i përket luftimit të krimit dhe korrupsionit

por, sipas tij, rekomandimi për vizat do të jetë pozitiv për shkaqe politike. Ai është shprehur kundër zgjedhjeve të parakohshme, duke theksuar se njëherë duhet të përfundojë reforma zgjedhore, e cila në vazhdimësi po prodhon kriza

Limaj: Është koha e fundit për konsensus kombëtar

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se është koha e fundit që subjektet politike të arrijnë një konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në Kuvendin e Dytë të Punës së Nismës, Limaj ka thënë se ky proces nuk i takon

vetëm një partie apo një mazhorance politike, por gjithë spektrin politik. Limaj, i cili mban postin e zëvendës kryeministrit, është shprehur i gatshëm ta marrë përgjegjësinë që i takon në këtë proces, duke i ftuar të gjitha subjektet politike të veprojnë njëjtë ■ FAQE 3



Kuvendi ta miratojë më shpejt draftstatutin e 'Trepçës'

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes "Trepça", Ardian Sylja, ka bërë me dije se gjendja momentale e kapaciteteve prodhuese në këtë ndërmarrje nuk është e kënaqshme. Në një bisedë për

gazetën "Epoka e re", Sylja ka theksuar se prodhimi në pesëmuorin e parë të këtij viti në minierat me flotacion Stantërg, Artanë dhe Kishincë është rreth 18 për qind më i ulët se në pesëmuorin e parë të vitit 2017

AKTUALE

KUSH PROVOKOI NË NDESHJEN SERBI - ZVICËR? F. 13



Bardhyl MAHMUTI

HAXHIU: DIALOGU ME SERBINË U NDËRTUA MBI PREMISA TË GABUARA F. 7

ERDOGANI DHE PARTIA E TIJ PRIJNË NË ZGJEDHJET NË TURQI F. 2

EKONOMI

RESHITAJ: KOSOVA ËSHTË NË FAZËN E MIRATIMIT TË STRATEGJISË PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE F. 9

MINISTRI BEQAJ MERR PJESË NË 'DIGITAL ASSEMBLY 2018'

F. 9

KULTURË

DOLI NGA SHTYPI LIBRI I HAJDIN ABazit, 'TAKIMI NË JUNIK' F. 6

SPORT

GËRBESHI: DO TA MPOSHTIM SANTA COLOMANIN F. 18

SOT ZHVILLOHEN KATËR NDESHJE PËR KUPËN E BOTËS F. 18

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ahmeti i bindur se shqiptarët do t'i përgjigjen pozitivisht referendumit për emrin

SHKUP, 24 QERSHOR - Kreu i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), Ali Ahmeti, është i bindur se shqiptarët do t'i përgjigjen pozitivisht referendumit eventual, i cili, sipas

paralajmërimeve, do të mbahet në vjeshtë. Ahmeti ka theksuar se zgjidhja e emrit është e një rëndësie të madhe, pasi në këtë mënyrë sigurohet ardhmëria e Maqedonisë,

raporton "Alsat-M". "Unë mendoj se shqiptarët janë të përgjegjshëm, e dinë rëndësinë e kësaj çështje kaq të madhe, prandaj për të ardhmen e shqiptarëve të Maqedoni dhe

vendit dhe do t'i përgjigjen pozitivisht referendumit, do të jenë pjesëmarrës, vulosës të një procesi jashtëzakonisht të rëndësishëm mbi të ardhmen", ka thënë Ahmeti.



Thaçi: Nga marrëveshja përfundimtare përfitojnë të dy vendet

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pas takimit me homologun e vet serb, Aleksandar Vuçiq, ka treguar se janë pajtuar që procesi i dialogut të rritet në javët e ardhshme. Sipas tij, arritja e marrëveshjes përfundimtare është në interes të dy vendeve dhe rajonit

"Epoka e re"

BRUKSEL, 24 QERSHOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pas përfundimit të takimit me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, i cili është zhvilluar të dielën në Bruksel me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini, ka bërë me dije se në këtë takim është biseduar për arritjen e një kornize të përgjithshme të marrëveshjes finale. "Ka qenë një takim jo i lehtë, por me tone pozitive për të shikuar kah e ardhmja për interesin e të dy vendeve. Jemi pajtuar që procesi të marrë një dinamikë dhe të shtohet në javët e ardhshme. Gjithashtu, kemi arritur në përfundim se arritja e marrëveshjes përfundimtare për normalizim të plotë të raporteve Kosovë - Serbi është në interesin e të dy vendeve, paqes dhe stabilitetit në rajon", ka thënë Thaçi. Presidenti Thaçi ka theksuar se një marrëveshje e tillë duhet të jetë e pranueshme për të dy popujt dhe, sipas tij, njerëzit



duhet të shikojnë kah e ardhmja evropiane. Sipas Thaçit, nëse Kosova dhe Serbia nuk arrijnë marrëveshje për normalizimin e raporteve, atëherë të dyja palët do të humbasin shumë. "E di se me marrëveshje do të mund të fitojmë shumë të dyja palët, por edhe jam i frikësuar se nëse nuk arrijmë marrëveshje do të humbasim shumë", u shpreh Thaçi, duke rikujtuar se Bashkimi Evropian, ku Kosova dhe Serbia synojnë të anëtarësohen, nuk pranon vende që kanë konflikte.

Ai ka thënë se kjo marrëveshje duhet të jetë e pranueshme për popullin e Kosovës dhe Serbisë. Presidenti Thaçi ka thënë se të

dyja palët duhet të punojnë në mënyrë progresive për arritjen e marrëveshjes. "Duhet të punojmë në paqe dhe stabilitet. Mos ta provokojmë njëri-tjetrin. Nuk është e lehtë të shkohet drejt zgjidhjes përfundimtare", ka thënë ai.

Presidenti shpreston se është momentumi i duhur për arritjen e kësaj marrëveshje.

Thaçi ka bërë me dije se pa një marrëveshje të plotë Kosova nuk mund ta realizojë qëllimin e vet për anëtarësim në NATO dhe BE. Gjithashtu, sipas tij, as Serbia nuk mund t'i realizojë qëllimet e veta pa një normalizim me Kosovën.

Ndërsa presidenti i Serbisë,

Aleksandar Vuçiq, ka thënë se gjatë takimit është folur për temat e hapura që kanë Serbia dhe Kosova. "Kemi biseduar për zgjidhjen e problemeve të hapura. Biseduam haptas për zgjidhjen e shumë problemeve. Nuk jam shumë optimist, por duhet të bisedojmë", është shprehur Vuçiq, duke shtuar se gjatë takimit është folur edhe për shtimin e takimeve në kuadër të dialogut që lehtësohet nga Brukseli.

Ndërkaq përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini, ka thënë se me presidentin e Kosovës dhe atë të Serbisë ka zhvilluar bisedime intensive dhe produktive për arritjen e një

marrëveshjeje për normalizimin e raporteve. "Përfaqësuesja e lartë dhe presidentët kanë pasur bisedime intensive dhe produktive mbi kornizën e marrëveshjes për normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes dy palëve. Palët janë pajtuar për shtimin e punës në javët e ardhshme", thuhet në njoftimin e zyrës së Mogherinit.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë zhvillohet në dy nivele, atë politik, ku delegacionet përfaqësohen nga presidentët e shteteve apo kryeministrat, dhe nivelin teknik, që zhvillohet përmes ekipeve të ekspertëve, ministrave dhe përfaqësuesve të institucioneve nga të dy shtetet.

Erdogani dhe partia e tij prijnë në zgjedhjet në Turqi

ANKARAJA, 24 QERSHOR - Rexhep Tajip Erdogan kryeson në zgjedhjet presidenciale të së dielës në Turqi, me një të pestën e votave të numëruara. Sipas raporteve të medias shtetërore, Erdogan ka marrë 59 për qind të votave dhe rivali më i afërt i

tij, Muharrem Ince, 27 për qind. Nëse Erdogan merr më shumë se 50 për qind të votave në total, ai do të shpallet fitues dhe do të evitohet një raund të dytë votimesh. Përveç presidencës, zgjedhësit votuan edhe për anëtarët e Parlamentit dhe po

sipas medieve shtetërore turke, partia e Erdoganit kryeson edhe këtu. Partia e tij, Drejtësi dhe Zhvillim, kryeson me 55 për qind të votave të numëruara deri në orën 21:00 të së dielës, ndërsa opozita CHP ka 14 për qind të votave.



Në praninë e afër 900 delegatëve, Nisma Socialdemokrate ka mbajtur të dielën Kuvendin e Dytë të Punës

Limaj: Është koha e fundit për konsensus kombëtar

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka bërë me dije se është koha e fundit që subjektet politike të arrijnë një konsensus kombëtar për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në Kuvendin e Dytë të Punës së Nismës, Limaj ka thënë se ky proces nuk i takon vetëm një partie apo një mazhorance politike, por gjithë spektrit politik. Limaj, i cili mban postin e zëvendëskryeministrit, është shprehur i gatshëm ta marrë përgjegjësinë që i takon në këtë proces, duke i ftuar të gjitha subjektet politike të veprojnë njëjtë



EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka ftuar spektrin politik ta gjejë gjuhën e përbashkët dhe të arrijë konsensus kombëtar rreth temave të mëdha për vendin. Në Kuvendin e Dytë të Punës së Nismës Socialdemokrate, që është mbajtur të dielën, Limaj ka thënë se këto tema nuk i takojnë vetëm një personi apo një partie, por të gjitha subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. "Në temat kombëtare Nisma di t'i dallojë nga qeverisja ditore, që është obligim dhe detyrë e marrë nga qytetarët e Republikës. Ne besojmë se temat kombëtare nuk janë të rezervuara për një individ apo grup politik dhe as për një mazhorancë. Ne besojmë fuqishëm se në temat kombëtare duhet të angazhohemi dhe të marrim përgjegjësi të gjitha grupet politike, të cilat janë të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës. Në këto tema duhet të marrim pjesë edhe personalitetet nga shoqëria civile që mund ta japin kontributin për temat e rëndësishme për vendin",

ka thënë Limaj.

Lideri i Nismës ka bërë me dije se ky subjekt politik si tema kombëtare llogarit liberalizimin e vizave, formimin e ushtrisë dhe dialogun me Serbinë. Ai ka deklaruar se përfundimisht vitin e ardhshëm qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm në BE, duke shtuar se edhe për formimin e ushtrisë ky subjekt do ta japë kontributin e vet. "Kontekstet e hapura në vendet e rajonit ka ardhur koha të mbyllen dhe përfundimisht t'i hapet një perspektivë e qartë rajonit drejt BE-së. Rruga për të shkuar drejt kësaj perspektive është dialogu. Nisma është e gatshme t'i marrë angazhimet e veta dhe përgjegjësinë në dialogun me Serbinë, pra për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura deri më tani, të cilat do të na çonin drejt një marrëveshje përfundimtare që do të krijonte mundësinë e njohjes reciproke mes dy shteteve tona, në mënyrë që Kosova të anëtarësohet në të gjitha organizatat ndërkombëtare", ka thënë Limaj, i cili mban postin e zëvendëskryeministrit në Qeverinë e Kosovës.

Para delegatëve të Nismës

Socialdemokrate, Limaj ka përmendur edhe parakushtet e këtij dialogu. "Ne besojmë se për të pasur sukses një dialog duhet të ketë gjithëpërfshirje, pra duhet një konsensus kombëtar. Ftoj të gjitha forcat politike që janë në Kuvend të mos ikin kësaj përgjegjësie, por të bashkohemi në Kuvend dhe të marrim përgjegjësi. Të angazhohemi dhe të bëjmë një konsensus sa më të gjerë në mënyrë që të marrim pjesë në këtë fazë finale të dialogut", është shprehur Limaj, duke shtuar se në këtë mënyrë ky proces do të garantonte besueshmëri dhe transparencë. "Ne nuk besojmë në dialog me individë, ne nuk besojmë në dialog që nuk është i përfshirë Kuvendi i Kosovës, ne nuk besojmë në një dialog që nuk përfaqëson vullnetin e shumicës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Koha e trafikimeve të temave të mëdha në Kosovë ka marrë fund dhe nuk mund të

trafikohen as këto bisedime siç ka ndodhur në ta kaluarën. Është koha e fundit që të gjithë të bëhemi bashkë dhe ta marrim përgjegjësinë që na takon", është shprehur Limaj.

Ndër të tjera, Limaj ka folur edhe për rrugëtimin e Nismës nga Kuvendi i parë i punës deri tek Kuvendi i dytë. Sipas tij, nga Kuvendi i Parë kjo parti kishte nxjerrë dy objektiva: të përfaqësohet në gjithë Kosovën nëpër asamblatë komunale dhe të përfaqësohet në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeveri. Ai ka thënë se tashmë të dyja këto objektiva janë përmbytur. Po ashtu, i pari i Nismës ka folur edhe për bashkëpunimin që do ta ketë me të gjitha subjektet politike. "Ne do ta vazhdojmë bashkëpunimin me të gjitha forcat politike në vend. Ne jemi në qeverisje me partnerët tanë të koalicionit. Nisma Socialdemokrate do ta vazhdojë partneritetin në qeverisje, do të jetë korrekte, e disiplinuar dhe e angazhuar plotësisht për zbatimin e programit qeveritar", ka thënë Limaj.

Ndërsa kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës, Jakup Krasniqi, ka thënë para delegatëve se kjo parti është parti e shpresës për qytetarët. Ai ka deklaruar se programi i Nismës është i hapur dhe kërkon të plotësohet çdo ditë e çdo orë nga intelektualët dhe ekspertët.

Krasniqi ka theksuar se gjatë këtyre viteve qytetarët kanë parë tek qeverisjet keq. "Me vendime jointucionale që e kanë dëmton vendin

dhe kryesisht gjatë këtyre viteve ka qeverisur e djathta. Kosovën duhet ta qeverisë një parti socialdemokrate dhe Nisma është shpresë për qytetarët e Kosovës. Nisma është një parti që i duhet Kosovës. Hapja e rrugëve të reja është e vështirë, por ato nuk bëhen pa ia nisur. Nisma do t'i ndihmojë të rinjtë e të rejtat të cilët duan të punojnë për një të ardhme më të mirë. Ky vend e ky komb nuk mund të ketë ardhmëri nëse shpëputet nga vlerat kombëtare e historike", ka shtuar Krasniqi.

Sekretari i përgjithshëm i Nismës Socialdemokrate, Bilall Sherifi, ka rikujtuar disa nga ngjarjet më të rëndësishme nga koha e themelimit të Nismës e deri më sot. "I rikujtoj këto ngjarje, sepse ishin vendimtare jo vetëm për rrugëtimin tonë politik, por për shkak se hapën një perspektivë të re për vendin. Ngjallja e shpresës për ndryshim ishte efekti i parë i themelimit të Nismës. Po rikujtoj shkurtimisht se që nga themelimi e deri para disa kohësh jemi ballafaquar me fushatë të tmerrshme kundër Nismës dhe udhëheqësve të saj. Po e përmend këtë fakt për të vetmen arsye, se dëshiroj që nga kjo foltore t'i falënderoj publikisht të gjithë aktivistët që i rezistuan luftës speciale, t'u shprehim një mirënjohje të madhe që nuk lëshuan pe para asnjë presioni dhe shantazhi dhe, falë vendosmërisë, arritën ta shndërrojnë Nismën Socialdemokrate në forcë të mirëfilltë politike parlamentare", ka thënë Sherifi.



Kryeparlamentari Ruçi uron Haradinajn për rizgjedhjen në krye të AAK-së

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi, ka uruar kryeministrin e Kosovës, Ramush Haradinaj, për rizgjedhjen në krye të Aleancës

për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Ruçi ka vlerësuar AAK-në si një parti të lirisë së Kosovës dhe Haradinajn për kontributin dhe lidhshërinë e shfaqur.

"Përgëzime Haradinaj për rizgjedhjen tuaj kryetar i AAK-së. Kjo është një parti e lirisë së Kosovës dhe rizgjedhja juaj është një vlerësim për kontributin dhe lidhshërinë tuaj. Haradinaj është një luftëtar i çlirimit, kontribuues i paqes dhe bashkëndertues i Kosovës demokratike", është thënë në urimin e Ruçi.

erishpin tuaj. Haradinaj është një luftëtar i çlirimit, kontribuues i paqes dhe bashkëndertues i Kosovës demokratike", është thënë në urimin e Ruçi.



Flet për "Epokën e re", Avni Klinaku

Qeveria aktuale s'ka ndrysh



Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka vlerësuar se Kosova aktualisht ka një gjendje jo të mirë dhe një perspektivë të zymtë. Ai ka thënë se në vazhdimësi kemi pasur qeveri që nuk janë përkujdesur për interesin e qytetarit dhe të vendit. Po ashtu, rolin e opozitës e ka vlerësuar të zbehtë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Klinaku ka deklaruar se Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë keq sa i përket luftimit të krimit dhe korrupsionit por, sipas tij, rekomandimi për vizat do të jetë pozitiv për shkaqe politike. Ai është shprehur kundër zgjedhjeve të parakohshme, duke theksuar se njëherë duhet të përfundojë reforma zgjedhore, e cila në vazhdimësi po prodhon kriza

ngadalësimi i këtij procesi nuk vjen për shkak të politikës ditore ose aftësisë dhe paaftësisë së kësaj Qeverie, por për shkak të kompetencave të mëdha që i janë dhënë komunitetit serb.

"Epoka e re": Z. Klinaku, çfarë vlerësimi keni për qeverisjen e vendit nga koalicioni PAN?

Klinaku: Qeveria aktuale nuk ka ndryshime prej qeverive të kaluara. Në vazhdimësi kemi pasur qeveri që nuk janë përkujdesur për interesin e qytetarit dhe të vendit, por për interesin e grupeve të caktuara partiake dhe familjare. Edhe roli i opozitës vazhdon të jetë i zbehtë, madje edhe më i zbehtë sesa në legjislaturat e kaluara. Prandaj, kemi një gjendje jo të mirë dhe një perspektivë të zymtë në krejt Kosovën.

"Epoka e re": Me këtë klasë politike, sa mund të jetë shpresuese e ardhmja e vendit?

Klinaku: Derisa kemi një qeverisje të keqe brenda Kosovës, edhe perspektiva e jashtme nuk është e mirë. Ndonëse perspektiva e jashtme

shpesh ndërlihet me raportet e tjera ndërkombëtare dhe Kosova mund të përfitojë në ato raporte, mirëpo për shkak të qeverisjes së brendshme do të ecim ngadalë edhe në aspektin ndërkombëtar.

"Epoka e re": Kosova ka avancuar në agjendën evropiane. Prisni rekomandim pozitiv për vizat?

Klinaku: Për shkaqe politike rekomandimi për vizat do të jetë pozitiv, përndryshe në aspektin e luftimit të korrupsionit Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë keq duke mos bërë kursesi përparime në atë drejtim. Madje duke e parë kushtin për luftim të korrupsionit në dritën e liberalizimit, është duke ngecur më tepër, sepse më tepër jemi të interesuar ta 'mashtrijmë' Bashkimin Evropian sesa ta luftojmë krimin e korrupsionin për hir të qytetarëve dhe zhvillimit të vendit. Liberalizimi i vizave shpresoj se do të bëhet për shkaqe politike e jo për arsye se Kosova ka bërë hapa në drejtim të luftimit të krimit dhe korrupsionit.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, të dielën ka shprehur skepticizëm sa i përket fazës finale të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se nuk do të arrihet marrëveshja historike në mes të dy vendeve meqë Serbia nuk ka qasje të zgjidhjes së problemeve. "Mirëpo do të shkohet drejt kompromiseve për minoritetin serb në mënyrë që mund të bëhet një lloj pajtimi,

duke i harruar problemet e vërteta në veri dhe në Luginë të Preshevës. Tendenca është krijimi i një lloj sigurie politike dhe ndoshta shtetërore për serbët në Kosovë në mënyrë që Serbia të largohet nga dialogu duke iu hapur rruga për BE, kurse Kosova do të mbetet me problemet e brendshme, kryesisht të shkaktuara nga komuniteti serb", ka deklaruar Klinaku.

Ai ka vlerësuar se Kosova aktualisht ka një gjendje jo të mirë dhe një perspektivë të zymtë si në aspektin e brendshëm, po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Sipas Klinakut, në vazhdimësi kemi pasur qeveri që nuk janë

përkujdesur për interesin e qytetarit dhe të vendit, si dhe roli i opozitës vazhdon të jetë i zbehtë. Ai ka shprehur optimizëm se rekomandimi për vizat do të jetë pozitiv për shkaqe politike meqë, sipas Klinakut, Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë shumë keq sa i përket luftimit të krimit dhe korrupsionit. Ai është shprehur kundër zgjedhjeve të parakohshme duke thënë se njëherë duhet të përfundojë reforma zgjedhore sepse procesi prodhon kriza. Klinaku ka folur edhe për formimin e ushtrisë së Kosovës duke thënë se

ime prej qeverive të kaluara



e kanë liberalizimin hiq më mirë nuk kanë qenë në aspektin e luftës kundër krimit dhe korrupsionit. Në Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, madje edhe në Shqipëri krimi dhe korrupsioni janë në lulëzim, por kanë liberalizim të vizave. Prandaj nëse Kosova krahasohet me vendet e tjera, mund të themi se na është bërë padrejtësi. Personalisht do të isha më i angazhuar në luftimin e krimit dhe korrupsionit për hir të qytetarëve sesa për hir të liberalizimit të vizave. Liberalizimi i vizave do të ishte dashur të vijë vetëm si rezultat i punës sonë të brendshme dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë. Kjo do të kishte ndikuar që qytetarët mos të kenë nevojë për të dalë jashtë dhe liberalizimi të ishte parë vetëm atraksion për turizëm dhe jo nevojë sociale.

"Epoka e re": Si e shihni fazën finale të dialogut me Serbinë?

Klinaku: Këtu jemi edhe më skeptikë për shkak se asnjëherë nuk i kemi shtruar çështjet ashtu siç duhet dhe për çfarë ka nevojë Kosova në atë dialog. Kosova i ka disa probleme me Serbinë, por ato nuk janë shtruar kurrë drejt, prandaj edhe nuk besoj se do të na vijë zgjidhje e drejtë. Mirëpo do të shkohet drejt kompromiseve për minoritetin serb në mënyrë që mund të bëhet një lloj pajtimi, duke i harruar problemet e vërteta në veri dhe në Luginë të Preshevës.

"Epoka e re": Nuk besoni në arritjen e marrëveshjes historike

në mes dy vendeve?

Klinaku: Nuk besoj se do të arrihet kjo marrëveshje sepse Serbia nuk ka qasje të zgjidhjes së problemeve, por kjo është shtruar si kusht i agjendës në BE. Edhe nëse e proklamojnë një marrëveshje historike, problemet do të mbesin sepse ajo nuk do t'i zgjidhë ato. Tensionet do të vazhdojnë deri në zgjidhjen përfundimtare të këtyre problemeve.

"Epoka e re": Nga kjo që po thoni ju, del se Kosova nuk do të përfitojë nga ky dialog, por do të ketë kompromise në dëm të shqiptarëve?

Klinaku: Gjithsesi ato kanë filluar dhe do të vazhdojnë. Tendenca është krijimi i një lloj sigurie politike dhe ndoshta shtetërore për serbët në Kosovë në mënyrë që Serbia të largohet nga dialogu duke iu hapur rruga për BE, kurse Kosova do të mbetet me problemet e brendshme, kryesisht të shkaktuara nga komuniteti serb.

"Epoka e re": Përderisa Kosova ka avancuar sa i përket dinamikës në procesin e dialogut, në anën tjetër ka ngecje në çështjet e brendshme siç është formimi i ushtrisë.

Klinaku: Ky ngadalësim i këtij procesi nuk vjen për shkak të politikës ditore ose aftësisë dhe paftësisë së kësaj Qeverie, por për shkak të kompetencave të mëdha që i janë dhënë komunitetit serb i cili mund t'i blloktojë ndryshimet kushtetuese, me ç'rast Kosova obligohet ta formojë ushtrinë përmes ligjit,

por që një gjë e tillë nuk mbështetet nga faktori ndërkombëtar. Problemet nuk janë zgjidhur, komuniteti serb ka privilegje deri bllokuese për Kosovën, prandaj e vonon edhe procesin e formimit të ushtrisë. Madje do të ketë vonesa në këtë drejtim për shkak se ndërkombëtarët nuk janë dakord për formimin e ushtrisë përmes ligjit, por përmes ndryshimeve kushtetuese dhe përmes kësaj të fundit serbët ose nuk pajtohen ose do të çesin kushte shumë të rënda dhe do të prolongohet edhe më tutje formimi i ushtrisë.

"Epoka e re": Z. Klinaku, si e komentoni kërkesën e partive opozitare për zgjedhje të reja, LB-ja është e gatshme për proces zgjedhor?

Klinaku: Nuk ka seriozitet në atë drejtim. Të gjitha partitë politike, edhe ato të opozitës, nuk janë të gatshme për zgjedhje edhe për shkak të problemeve të brendshme, fuqisë elektorale dhe raporteve në mes tyre. Për shkaqe të tjera dhe për shkaqe financiare më mirë do të ishte të mos ketë zgjedhje në këtë kohë. Veçanërisht jemi të interesuar për një reformë të mirëfilltë zgjedhore e cila jep mundësi për zgjedhje më demokratike. Duhet të përfundojë reforma zgjedhore sepse, fatkeqësisht, procesi zgjedhor në vazhdimësi po prodhon kriza. Nuk është shumë i rëndësishëm fati i LB-së sesa është i rëndësishëm fati i Kosovës. Pas çdo procesi zgjedhor kemi bllokada të cilat po na vonojnë në zhvillimin ekonomik dhe në sfera të tjera.

"Epoka e re": Meqë kushtet nuk janë plotësuar, do të thotë se BE-ja nuk qenka e padrejtë ndaj Kosovës siç deklarojnë shpeshherë liderët.

Klinaku: Edhe vendet që tashmë

ShBA: Pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës janë të përhershme

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Komiteti për Punë të Jashtme i Dhomës së Përfaqësuesve ka thënë se pretendimet e Serbisë, se shtetet po ia kthejnë shpinën Kosovës, janë të rreme. Në një postim në rrjetin social "Twitter", Komiteti për Punë të Jashtme ka thënë se "pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës janë të përhershme". "Pretendimet mashtruese të Serbisë, se shtetet po ia kthejnë shpinën Kosovës, janë të rreme dhe po shkaktojnë zemërim në mbarë botën. Serbia duhet të ndalë këtë dhe të kthehet në normalizimin e raporteve me fqinjën e vet. Pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës janë të përhershme", thuhet në këtë postim të

Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve. Ditë më parë ministri i Jashtëm i Serbisë, Ivica Dačić, ka deklaruar se shteti i Liberisë ka tërhequr njohjen e Kosovës. Por, ky lajm u demantua nga Ministria për Punët të Jashtme e Kosovës dhe nga vetë shteti i Liberisë. Edhe më herët Beogradi zyrtar ka plasuar lajme se shtete të ndryshme kanë tërhequr njohjen, siç ishte rasti i Guinea Bisaut dhe shtetit të Ganës, por në të dyja rastet Prishtina zyrtare i ka demantuar këto lajme. Kosova ka akredituar ambasadorin e vet në Guinea Bisau, ndërkaq shteti i Ganës ka akredituar ambasadorin e vet në Prishtinë.



Kush provokoi në ndeshjen Serbi - Zvicër?



Bardhyl MAHMUTI

Nëse u hidhet një sy medieje serbe, shihet qartë se humbjen nga ekipi i Zvicrës në këtë Botëror e kanë përjetuar shumë më rëndë, për arsye se dy shënuesit e golave ishin me origjinë shqiptare nga Kosova. Në pamundësi ta gëlltisnin këtë humbje, gazetarët serbë e përqendruan vëmendjen në

simbolin e shqiptarëve, që bënë me duar Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri, pas shënimit të golave. Ky gjest i lojtarëve me origjinë shqiptare "u përjetua si provokim i rëndë ndaj serbëve, gjest për të cilin, sipas tyre, duhet të ndërhyjë edhe FIFA!"

Qëndrime të tilla dhe të ngjashme me të vërshuan në shumicën e medieje elektronike serbe. Dhe jo vetëm serbe! Fjala "provokim" zuri vend edhe në disa medie të huaja! Simboli me duar, si aluzion për shqiptarët dykrenorë, nuk përmban asnjë element provokues ndaj askujt. Është shenjë, të cilën rinia shqiptare e ka shndërruar në simbol

identifikimi në momente të veçanta. Ajo nuk i drejtohet si provokim askujt, e hiç më pak në një ndeshje sportive.

A mund të konsiderohet si provokim ndaj dikujt, kur pas shënimit të golit, një numër futbollistësh bëjnë simbolin e kryqit dhe ngrënë gishtat drejt qiellit, apo kur dikush tjetër përkulet në tokë dhe bie në "sexhde" sipas rritit islam?! Lojtari që e përdor këtë simbol për të shprehur gëzimin e vet nuk përmban asnjë provokim ndaj askujt! E njëjta gjë vlen edhe për simbolin e shqiptarëve me duar, me të cilën identifikohen sportistët shqiptarë, dhe jo vetëm ata.

Në ndeshjen Serbi-Zvicër pati

provokime, madje provokime shumë të mëdha! Dhe jo vetëm ndaj shqiptarëve!

Fillimisht duhet të reagohet ashpër kundër ndalimit të flamurit tonë kombëtar dhe atij të Kosovës, në një ndeshje ndërkombëtare, sepse kjo përbën provokimin më të madh që na bëhet ne si shqiptarë të këtyre dy shteteve të pavarura. Nuk është provokim flamuri i Kosovës në këpucët e futbollit të Xherdan Shaqirit, por ndalesa e flamujve tanë. Gjatë gjithë ndeshjes tifozët serbë brohoritnin refrenin "Ubi, Zakoli, dok Shipatar ne postoi" (Vra, pre, derisa të mos ekzistojnë shqiptarët!). Ndaj cilit akt duhet të reagojë FIFA?

Ndaj brohoritjeve gjenocidare serbe, apo kundër Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit, pse këta bënë simbolin e shqiptarëve dykrenorë?

Brohoritjet gjenocidare janë provokim ndaj mbarë njerëzimit dhe jo vetëm shqiptarëve.

Ata që u përkujdesën të mos futet në stadium asnjë flamur shqiptar apo i Kosovës, nuk u shqetësuan fare që një numër tifozësh serbë kishin hyrë në stadium me fanellat që kishin si portret Ratko Mlladiqin, kriminelin serb të dënuar për gjenocid në Bosnjë. Dhe pas gjithë kësaj, kanë pafytyrësinë të flasin për provokim ndaj serbëve!



Ismaili: Gjatë këtij viti do të realizojmë mijëra vizita sistematike të ekipeve mjekësore

FERIZAJ, 24 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka njoftuar se gjatë këtij viti do të realizojnë mijëra vizita sistematike të ekipeve mjekësore në tërë Kosovën, nga programi i vizitave për nëna dhe fëmijë. "Omeri, një vjeç nga Manastirci i Ferizajt, do të ketë fëmijëri më të shëndoshë falë vizitave sistematike të ekipeve tona mjekësore nga programi i

vizitave për nëna dhe fëmijë. Gjatë këtij viti do të realizojmë mijëra vizita të tilla, kurse Omeri uroj të bëhet një nga kampionët tanë me të cilin nesër do të krenohemi të gjithë", ka shkruar ministri Ismaili në llogarinë e vet në "Facebook".


Projekti i vizitave për nëna dhe fëmijë, i cili deri sot ka qenë aktiv në 12 komuna, ka zhvilluar

mijëra vizita vetëm gjatë vitit 2018. Në vitin 2018 ky program është shtrirë në tri komuna të tjera, Dardanë, Shtime, Viti dhe në Kaçanik. Përmes këtij programi është mundësuar qasje për të gjithë në shërbimet shëndetësore dhe është përmirësuar cilësia e shërbimeve. Po ashtu, mbrojtja sociale është një nga shtyllat e ngritura të këtij projekti.

Doli nga shtypi libri i Hajdin Abazit, 'Takimi në Junik'

Prishtinë, 24 qershor - Ka dalë nga shtypi libri "Takimi në Junik" i autorit Hajdin Abazi, botuar nga Kolegji AAB. Kujtimet e njërit prej ish-prorëve të UÇK-së, i cili e pati prituri në takim emisarin e presidentit Klinton, ambasadorin Richard Holbrooke, botohen me rastin e 20-vjetorit të takimit i cili qe bërë më 24 qershor të vitit 1998. Shpesh është shkruar ndër vite për këtë takim, por në këtë libër paraqitet për herë të parë rrëfimi i plotë për takimin e parë publik diplomatik SHBA-UÇK. Në këto kujtime përshkruhet e tërë rrjedha - si

erdhi deri te takimi i ambasadorit Richard Holbrooke me skuadrën për marrëdhënie me publikun (MP) të Shtabit të Nënzonës Operative të UÇK-së për Junik dhe Rekë, Hajdin Abazi alias Lum Haxhiu dhe Gani Shehu: çka u bisedua, për çka u shprehën frekuencat e njëjta, ku pati mospajtime, pse ishte i papranueshëm propozimi që forcat armike të kalonin përmes Junikut, çfarë u tha për pavarësinë dhe çka u kërkua prej UÇK-së, cilat ishin pajtimet themelore që u manifestuan e që koha i provoi të vërteta katërcipërisht.



Haxhiu: Dialogu me Serbinë u ndërtua mbi premisa të gabuara

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, të dielën në një konferencë për medie ka folur rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi, marrëveshjeve të dëmshme që ka sjellë ky proces. Ajo ka theksuar se ky proces i dialogut ishte ndërtuar mbi premisa të gabuara, duke theksuar se nuk mund të vazhdohet një fazë e re e dialogut pa e pasur një vlerësim për këtë proces



EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur të dielën konferencë për media, në të cilën kanë folur për procesin e dialogut me Serbinë gjatë periudhës 2011-2017. Deputetja e LV-së, Albulena Haxhiu, ka folur mbi marrëveshjet e dëmshme që ka sjellë ky proces i dialogut. "Para shtatë vjetëve, në kohën kur nisi procesi i dialogut me Serbinë, u tha se do të ishte thjesht në proces teknik dhe se nuk do të diskutohet për çështje të brendshme të Kosovës. Në fakt, ishte dialog politik i ndër-

tuar mbi premisa të gabuara", ka thënë Haxhiu. Ajo ka shtuar se presidenti Hashim Thaçi në takime me presidentin serb Aleksandar Vuçiq nuk e përfaqëson shtetin e Kosovës, por veten. "Thaçi sot në takim me (Aleksandar) Vuçiqin nuk përfaqëson Kosovën. Ai veç veten mund të përfaqësojë atje. Kosovës i duhet një bilanc. Duhet një pasqyrë e plotë për marrëveshjet nga energjia te telekomunikacioni, nga liria e lëvizjes te njohja e diplomave, nga policia e gjyqësia në veri te përfaqësimi diplomatik i ndërsjellë, nga menaxhimi i përbashkët i kufirit e deri te denominimi antikushtetues i Republikës së Kosovës (fusno-

ta). Hashim Thaçi duhet të ndalet. Askush nuk mund të pranojë dëme të reja për avazet e tij", ka thënë deputetja Haxhiu. Ajo ka theksuar se nuk mund të vazhdohet një fazë e re e dialogut pa e pasur një vlerësim për dialogun. "Ne nuk mund të vazhdojmë në një fazë të re të dialogut pa e pasur një vlerësim për dialogun, pa vendosur se me çfarë korniza do të

paraqitemi në marrëdhëniet e tilla dhe se çfarë do të fitojë Kosova prej proceseve të tilla", është shprehur deputetja Haxhiu. Ndërkaq nënkryetarja e Lëvizjes Vetëvendosje dhe deputetja, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka thënë se Qeveria ka mungesë të legjitimitetit pasi ka numra minimalë në Kuvend ndërsa, sipas saj, presidenti Hashim

Thaçi është plotësisht jokredibil dhe nuk paraqet unitetin e vendit. "Me një president jokonsensual dhe jokredibil, i cili ka nënshkruar marrëveshje të dëmshme si ajo për Zajednicën dhe pa u bërë një bilanc për të gjitha marrëveshjet e arritura deri tani pala e Kosovës, do të vazhdojë me kompromise të reja", ka thënë Fatmire Mulhaxha-Kollçaku.



Veseli: PDK-ja gjithmonë u ka dhënë hapësirë të rinjve

VUSHTRRI, 24 QERSHOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, para delegatëve të Rinisë Demokratike në Vushtrri ka thënë se liberalizimi i vizave do të ndodhë gjatë këtij viti. Por, sipas Veselit, të rinjtë kanë besim dhe do ta ndërtojnë të

ardhmen e tyre në shtetin e Kosovës nëpërmjet ideve të reja. Ai ka theksuar se Partia Demokratike e Kosovës (PDK) beson tek rinia dhe idetë e tyre për ta zhvilluar dhe integruar Kosovën gjatë Dekadës së Re në Bashkimin Evropian. "Partia Demokratike e

Kosovës beson tek rinia dhe energjia që të rinjtë sjellin. PDK-ja gjithmonë ua ka dhënë hapësirën meritore të rinjve në vendimmarrje. Ju sot po filloni një angazhim të ri politik për të ardhmen më të mirë të vendit. Mbi 20 mijë të rinj anekënd Kosovës i janë bashkuar

PDK-së për Dekadën e Re dhe kjo është dëshmia më e mirë se partia jonë po fuqizohet dhe reformohet me energji e ide të reja për të ardhmen e shtetit", ka deklaruar Veseli. Në këtë kuvend zgjedhor i pranishëm ishte edhe ministri i

Shëndetësisë, Uran Ismaili, i cili ka thënë se platforma Dekada e Re është krijuar nga lideri i Partisë Demokratike, Kadri Veseli, për të rinjtë e vendit pasi, siç ka thënë Ismaili, PDK-ja beson tek rinia dhe i jep asaj hapësirën e merituar në vendimmarrje.

Flet për "Epokën e re", Ardian Syla

Kuvendi ta miratojë më shpejt draf

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës të Ndërmarrjes "Trepça", Ardian Syla, ka bërë me dije se gjendja momentale e kapaciteteve prodhuese në këtë ndërmarrje nuk është e kënaqshme. Në një bisedë për gazetën "Epoka e re", Syla ka theksuar se prodhimi në pesëmujorin e parë të këtij viti në minierat me flotacion Stantërg, Artanë dhe Kishincë është rreth 18 për qind më i ulët se në pesëmujorin e parë të vitit 2017. Ai ka thënë se aprovimi sa më i shpejtë i statutit të ndërmarrjes "Trepça" nga ana e Kuvendit të Kosovës do t'i hapte rrugë zhvillimit të gjithëmbarshtëm të kësaj ndërmarrje



"Epoka e re": Prej se Ligji për "Trepçën" ka hyrë në fuqi, sa ka arritur të gjejë miratim, kur dihet se u formua dhe një grup punues për hartimin e draftstatutit?

Syla: Ligji për "Trepçën" ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2016, mirëpo që nga atëherë është bërë shumë pak për zbatimin e këtij ligji. Ligji parasheh transformimin e njësive të "Trepçës" nga ndërmarrja shoqërore "Trepça" në ndërmarrje publike e cila është në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës me 80 për qind dhe punëtorëve të "Trepçës" me 20 për qind. Një ndër detyrat kryesore të ligjit është hartimi dhe propozimi i draftstatutit nga Bordi Mbikëqyrës i cili më pastaj do të duhej të aprovohej nga Kuvendi i Kosovës. Puna kryesore e Bordit Mbikëqyrës që nga marrja e mandatit ka qenë hartimi i draftstatutit të "Trepçës sh. a." dhe konsideroj që si Bord kemi bërë një punë të mirë në këtë drejtim, ku në bashkëpunim me Ministrinë e

Zhvillimit Ekonomik kemi hartuar draftstatutin dhe të njëjtin e kemi dërguar në Qeverinë e Kosovës dhe shumë shpejt presim të miratohet nga Kuvendi i Kosovës, me çfarë do të mundësohet që "Trepça" të regjistrohet si ndërmarrje publike.

"Epoka e re": Si është raporti me menaxhmentin e pjesës veriore dhe a keni zhvilluar ndonjë takim prej emërimit tuaj në këtë pozitë?

Syla: Në kuadër të ndërmarrjes operon edhe njësia biznesore Minierat me Flotacion Kopaonik-Leposaviç që shtrihet në pjesën veriore të vendit tonë dhe komunikimi me menaxhmentin e kësaj njësie ka pasur vështirësitë e veta edhe për shkak të problemeve tashmë të ditura politike. Në funksion të zbatimit të Ligjit për "Trepçën", i cili e parasheh ndërmarrjen "Trepça" si një dhe të vetme, që nga marrja e mandatit si kryesues Bordi i ndërmarrjes kam bërë përpjekje të vazhdueshme për koordinimin e

aktiviteteve të ndërmarrjes edhe me pjesën veriore. Pa marrë parasysh vështirësitë, mendoj se me kompletimin e Bordit Mbikëqyrës edhe me tre anëtarët përfaqësues të njësive biznesore që vepron në pjesën veriore të Kosovës do të mundësohet një komunikim i vazhdueshëm dhe korrekt në pajtueshmëri me Ligjin për "Trepçën".

"Epoka e re": Sa po mund të operoni, pasi që pozitën e anëtarëve të bordit nga komuniteti serb ende nuk janë funksionale?

Syla: Funkcionimi dhe vendimarrja e Bordit Mbikëqyrës të "Trepçës" është e rregulluar me Ligjin për "Trepçën" si ligj bazik si dhe me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Bordi Mbikëqyrës duhet të ketë nëntë anëtarë. Për momentin jemi pesë anëtarë të përzgjedhur nga Qeveria e Kosovës dhe një anëtar i cili përfaqëson interesat e punëtorëve të ndërmarrjes dhe vendimarrja

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 QERSHOR -

"Epoka e re": Z. Syla, cila është gjendja momentale e kapaciteteve prodhuese të "Trepçës"?

Syla: Funkcionimi i Ndërmarrjes "Trepça", duke përfshirë edhe njësitë prodhuese, që nga paslufta është përcjellë me vështirësi të shumta. Gjendja momentale e kapaciteteve prodhuese nuk është e kënaqshme. Prodhimi në pesëmujorin e parë të vitit 2018 në minierat me flotacion Stantërg, Artanë dhe Kishincë është rreth 18 për qind më i ulët se në pesëmujorin e parë të vitit 2017 dhe arsyet për këtë performancë jo të mirë të njësive prodhuese janë në kuadër të sfidave me të cilat po përballemi. Miratimi i Ligjit për "Trepçën" ka qenë një hap tejet i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i cili e ka shpëtuar "Trepçën" nga falimentimi apo likuidimi eventual. Mirëpo, vështirësitë në zbatimin e këtij ligji, vonesat në emërimin e Bordit Mbikëqyrës si dhe vonesat në hartimin dhe aprovimin e Statutit të Ndërmarrjes "Trepça sh. a." kanë ndikuar në performancën jo të mirë të ndërmarrjes. Prandaj, aprovimi sa më i shpejtë i statutit të ndërmarrjes nga ana e Kuvendit të Kosovës do t'i hapte rrugë zhvillimit të gjithëmbarshtëm të ndërmarrjes.

"Epoka e re": Cilat janë sfidat me të cilat po përballen ndërmarrja "Trepça"?

Syla: Për tërë periudhën e pas luftës ndërmarrja "Trepça" është ballafaquar me mungesë të të statusit zhvillimor të saj. Mungesa e teknologjisë moderne, mungesa e fuqisë së re punëtoresh, investimet e nevojshme kapitale në miniera me flotacione ka bërë që të ketë prodhim dhe produktivitet jo të kënaqshëm. Sfidat kryesore me të cilat po përballen "Trepça" janë: Mungesa e fuqisë së re

punëtoresh që është një ndër sfidat kryesore, pasi moshë mesatare e punonjësve në "Trepçë" është mbi 52 vjet dhe, duke pasur parasysh natyrën e veprimtarisë pa rekuritim të fuqisë së re punëtoresh s'mund të kemi prodhim të kënaqshëm. Rekrutimi i fuqisë së re punëtoresh, qoftë në kuptimin e moshës apo edhe kuadrove, është i nevojshëm. Teknologjia e vjetruar është sfidë me të cilën përballen "Trepça". Investimet në teknologjinë moderne do të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e proceseve teknologjike në ndërmarrje, pasi do të rriteshin kapacitetet prodhuese. Pra, investimet në resurset njerëzore dhe teknologji të re janë parakushte për zhvillimin e ndërmarrjes. Kemi pastaj sfidat mjedisore. Këtu kemi të bëjmë me shumë deponi të mbetjeve industriale të cilat janë prodhuar nga aktivitetet minerare të "Trepçës" që nga viti 1930. Këto çështje patjetër duhen adresuar në mënyrë që të shmangen problemet mjedisore siç janë kontaminimet e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, ndotja e ambientit dhe ndotjet e tjera. Trajtimet e mbetjeve industriale duhet të bëhen duke aplikuar standardet bashkëkohore të trajtimit të tyre.

"Epoka e re": Sa ka pasur eksport të resurseve të "Trepçës" në gjashtëmujorin e parë të këtij viti dhe si është raporti me vitin e kaluar?

Syla: Resurset kryesore të "Trepçës" janë xehet e plumbit dhe zinkut. Ndërmarrja në vazhdimësi bën eksportin e këtyre resurseve. Prodhimi në pesëmujorin e parë të vitit 2018 është dukshëm më i ulët krahasuar me periudhën pesëmujore të vitit 2017 dhe domosdoshmërisht rezulton se edhe eksportet e resurseve janë më të ulëta. Nëse krahasojmë pesëmujorin e parë të vitit 2018 me pesëmujorin e parë të vitit 2017 rezulton se eksporti i plumbit dhe zinkut (dy resurseve kryesore të Trepçës) ka qenë rreth 25 për qind më i ulët.

Statutinin e 'Trepçës'

në Bord bëhet me shumicë të thjeshtë. Pavarësisht se Bordi ka kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjeve dhe marrjen e vendimeve, mendoj se plotësimi me tre anëtarët e tjerë duhet të bëhet në një afat sa më të shpejtë të mundshëm.

"Epoka e re": A ka pasur interesim nga investitorët e huaj për "Trepçën"?

Syla: Që nga momenti i emërimit të Bordit Mbikëqyrës, më shumë kemi pasur takime me organizata ndërkombëtare të cilat janë të gatshme të ndihmojnë në forma të ndryshme në zhvillimin e ndërmarrjes "Trepça". Më saktësisht, kemi takuar delegacionin e Bankës Botërore që ka të bëjë me trajtimin e mbetjeve industriale, projekt për të cilin BB-ja është e gatshme të japë edhe donacione të ndryshme. Mirëpo, gjitha këto donacione s'mund të ndodhin në këtë fazë për shkak të mosdefinimit të statusit të ndërmarrjes. Prandaj, kalimi i Statutit të Ndërmarrjes dhe regjistrimi i saj është nevojë imediate.

"Epoka e re": U bë polemikë edhe sa i përket trajtimit të zonave me interes të veçantë, se duhet të jenë në pronësi të "Trepçës". Si duhet të zgjidhet kjo çështje?

Syla: Zonat me interes janë çështje të cilat duhet të trajtohen sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, prandaj edhe janë duke u shqyrtuar në Komisionin Parlamentar për Zhvillim Ekonomik.

"Epoka e re": Është paralajmëruar protestë nga përfaqësuesit e Sindikatës së "Trepçës" në rast se në draftstatutin nuk përshihen kërkesat e tyre, si: Ligji për pen-

sione, Ligji për invalid, stazhi i punës prej viteve '89-'99, sigurimet shëndetësore etj.?

Syla: Punëtorët e "Trepçës" janë sinonim i qëndresës dhe rezistencës së popullit tonë në periudha të ndryshme kohore. Kontributi dhe sakrifica e tyre duhet vlerësuar dhe respektuar në maksimum. Qëllimi kryesor dhe roli i Bordit Mbikëqyrës është që, krahas zhvillimit të ndërmarrjes, të marrë edhe vendime të cilat ndikojnë në mirëqenien dhe dinjitetin e punëtorëve të ndërmarrjes. Çështjet sociale duhet të zgjidhen përmes formave të duhura dhe institucioneve qeveritare, prandaj Bordi Mbikëqyrës ka propozuar që çështjet sociale të zgjidhen me ligj të veçantë për të gjithë punëtorët e "Trepçës". Për këtë iniciativë janë pajtuar të gjithë anëtarët e Komisionit Parlamentar të Zhvillimit Ekonomik, ku për momentin jemi duke diskutuar statutin e "Trepçës". Futja e çështjeve sociale në statut nuk është zgjidhje e duhur, pasi Statuti i Ndërmarrjes "Trepça" mund të ndryshojë në çdo kohë dhe kjo rrjedhimisht nuk do t'i zgjidhte problemet sociale, por do të krijonte obligime financiare për ndërmarrjen të cilat do të ishin të papërbalueshme. Prandaj, mënyra e vetme që çështjet sociale të zgjidhen njëherë e përgjithmonë për gjithë punonjësit e "Trepçës" është përmes ligjit të veçantë. Bordi Mbikëqyrës i siguron gjithë punëtorët e "Trepçës" se të gjitha vendimet tona do të jenë të menduara mirë dhe në harmoni me ligjet në fuqi. Krahas zhvillimit të qëndrueshëm të ndërmarrjes "Trepça" sh. a. do të trajtohen edhe të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punëtorët.



Reshitaj: Kosova është në fazën e miratimit të Strategjisë për ndryshimet klimatike

VJENË, 24 QERSHOR (ER) - Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, ka marrë pjesë në Këshillin Joformal Ministror, të organizuar nga Komuniteti i Energjisë në Vjenë, në të cilin kanë marrë pjesë ministra, zëvendësministra, sekretarë shteti, nga fusha e mjedisit, ekonomisë e energjisë të shteteve të ndryshme, duke përfshirë Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë, Serbinë, Hungarinë, Austrinë, Gjermaninë, Danimarkën, Ukrainën, Gjeorgjinë etj. Në fjalën e saj para të pranishmëve ministri Reshitaj ka folur për sfidën e ndryshimeve kli-

matike me të cilën po ballafaqohet bota, me ç'rast ka kërkuar që shtetet bashkërisht të punojnë për reduktimin e ngrohjes globale sepse, sipas saj, duke marrë në konsideratë që jetojmë në një "fshat global", ku problemet e një shteti kanë ndikime edhe në shtetet e tjera, përpjekjet dhe kujdesi për botën duhet të jenë të përbashkëta. "Kosova është në fazën e miratimit të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike duke u angazhuar për reduktimin e ngrohjes globale, reduktimin e emisioneve ndotëse nga industria, duke promovuar ekonominë e gjelbër dhe energjinë e ripërtëritshme në vend", ka thënë ministri Reshitaj.



Ministri Beqaj merr pjesë në 'Digital Assembly 2018'

SOFJE, 24 QERSHOR (ER) - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrjes, Besim Beqaj, do të marrë pjesë "Digital Assembly 2018", organizuar nga Komisioni Evropian dhe Presidenca Bullgare e Këshillit të BE-së, me ftesë të komisioneres së BE-së për Ekonomi Digjitale, Mariya Gabriel. "Digital Assembly" është një forum i madh vjetor që mbledh më shumë se 1 000 palë të interesuara dhe politikëbërës të nivelit të lartë, për të debatuar për politikën digjitale të BE-së dhe imp-

likimet e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe mbahet më 25 dhe 26 qershor në Sofje të Bullgarisë. Ministri Besim Beqaj është pjesë e panelit "Lansimi i agjendës digjitale për Ballkanin Perëndimor" së bashku me komisionaren Mariya Gabriel dhe ministrat e rajonit, për t'i shpalosur të arriturat dhe planet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e agjendës digjitale. Ministri Beqaj, gjithashtu, do të jetë pjesë e pritjes nga presidenti dhe kryeministri i Bullgarisë.

Nis ndërtimi i shkollës së re në Llukë të Epërme të Deçanit

Deçan, 24 qershor (ER) - Në fshatin Llukë të Epërme të Komunës së Deçanit, konkretisht te Verrat e Llukës, aty ku dikur mbaheshin kuvendet e mëdha, kanë filluar punimet për ndërtimin e objektit të ri shkollor të shkollës "Kuvendi i Verrave të Llukës". Shkolla e re, e cila do të ndërtohet, do t'i plotësojë kushtet për mbajtjen e mësimin të 113 nxënësve të këtij lokaliteti, duke pasur parasysh edhe objektin ekzistues i cili ishte ndërtuar me vetëkontributin e fshatit. Ky objekt shkollor do të financohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me Komunën e Deçanit.



Të pranishëm në fillimin të punimeve të kësaj shkolle kanë qenë kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Qazim Maloku me bashkëpunëtorë, drejtoresha e shkollës

"Kuvendi i Verrave të Llukës", Besarta Tahirukaj, veterani i arsimit të këtij fshati, Hysen Molliqaj, nxënës, mësimdhënës dhe prindër të cilët e kanë pritur me entuziazëm fillimin e punimeve të kësaj shkolle.

Vazhdon rivarrimi i dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Marinë

SKENDERAJ, 24 QERSHOR (ER) - Është duke vazhduar procesi i zhvarrimit të dëshmorëve nga fshati Polac për në Kompleksin Memorial në Marinë. Drejtuesit e Komunës së Skenderajt kanë bërë me dije se ky proces është duke shkuar sipas planit. Për ta parë nga afër procesin e zhvarrimit dhe rivarrimit të dëshmorëve të

UÇK-së, gjatë fundjavës kanë qenë të pranishëm drejtorët e drejtorive nga Komuna e Skenderajt dhe deputeti i PDK-së, Bekim Haxhiu. "Dëshmorët e lirisë po rivarrosen me nderimet më të larta ushtarake dhe shtetërore. Lavdi të gjithë dëshmorëve!", është thënë në njoftimin e Komunës së Skenderajt.



Qytetarët e Pejës kërkojnë të përmirësohet gjendja në arsim dhe shëndetësi



PEJË, 24 QERSHOR (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Besa Gaxherri, Hajdar Beqa, Fatmire Kollçaku, Dukagjin Gorani, Muharrem Nitaj dhe Hykmete Bajrami, në vazhdim të aktivitetit "Ditët e Kuvendit", kanë takuar në Pejë qytetarë të kësaj ane, me të cilët kanë bashkëbiseduar lidhur me nevojat, shqetësimet dhe kërkesat që ata kanë. Takimi është mbajtur në teatrin profesional "Istref Begolli" të këtij qyteti, ndërkaq qytetarë të shumë

pejanë nga përfaqësuesit e tyre parlamentarë kërkuar sqarime dhe ngritjen e çështjeve për të cilat ata janë të shqetësuar në jetën e përditshme. Me këtë rast, ndër çështjet për të cilat u shfaq interesim më i madh nga qytetarët ishte ajo e procesit të bisedimeve me Serbinë, rruga Deçan - Plavë, gjendja në shëndetësi dhe arsim në të gjitha nivelet, turizmi, gjendja e ambientit, si dhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e deputetëve, të cilët edhe iu përgjigjën

interesimit të tyre.

Deputetët i njoftuan qytetarët e Pejës edhe për ecurinë dhe procesin e miratimit të disa projektligjeve, për të cilat gjatë debatit të pranishmit shfaqën interesim. Në fund të këtij takimi u vlerësua se bashkëbisedimi ndërmjet qytetarëve dhe të zgjedhurve të tyre është i dobishëm, andaj u tha se praktikat si kjo e sotmja duhet ndjekun edhe në të ardhmen. Takimi është mbajtur me iniciativë të Forumit për Transparencë Parlamentare.

Në Mitrovicë u hap ekspozita e piktorëve boshnjakë nga Novi Pazari


MITROVICË, 24 QERSHOR (ER) - Në ambientet e Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica", buzë Ibrit, është hapur ekspozita e piktorëve e autorëve boshnjakë nga Novi Pazari, Edis Muminoviq, Esad Jashareviq, Mersija Gjankoviq-Jashareviq dhe Nermin Qeman. Kjo ekspozitë është hapur nën organizimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Mitrovicës dhe është mbështetur nga Qendra Rajonale e OSBE-së në Mitrovicë.

Nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, ka thënë se është mirë që

DKRS u ka mundësuar qytetarëve të Mitrovicës, në veçanti dashamirëve të pikturës, të shikojnë këtë ekspozitë me piktura të bukura të autorëve boshnjakë nga Novi Pazari. Ai ka përsëritur edhe piktorët nga Shqipëria që ishin të pranishëm në hapjen e kësaj ngjarje të rëndësishme kulturore. "Ne në Mitrovicë po bëjmë përpjekje ta begatojmë sa më tepër jetën kulturore dhe qytetarëve t'u ofrojmë vlera të mirëfillta. Besoj se kjo ekspozitë ka vlera të tilla dhe unë ju uroj sukses piktorëve nga Novi Pazari", ka deklaruar

Mujka.

Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rinë dhe Sport, Tafil Peci, ka theksuar se kjo është një ekspozitë e veçantë e artistëve nga Novi Pazari, të njohur për vlerat e tyre krijuese. "Qëllimi i ekspozitës është që qytetarëve të komunës t'u ofrojmë edhe vlera të tjera artistike, edhe pse këto janë të ngjashme me ato që krijohen tek ne. Kemi përzgjedhur piktorët dhe pikturat më të mira që krijohen në Sanxhak dhe Novi Pazar. Falënderojmë shumë OSBE-në që na ka mbështetur për hapjen e kësaj ekspozite", ka thënë Peci.



Gjilani shënon Ditën Kulturore Japoneze

GJILAN, 24 QERSHOR (ER) - Me aktivitete të shumta, të cilat janë mbajtur nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kjo komunë ka shënuar Ditën Kulturore Japoneze. Fillimisht kryetari Haziri ka pritur në zyrën e vet shefin e zyrës nga Ambasada e Japonisë në Vjenë,

Mitsunori Ogasawara, më pas kanë parë nga afër ekspozitën e nxënësve të shkollës së arteve, aktivitetet sportive të arteve marcialle, për të vazhduar me shfaqjen e fotografive në hollin e teatrit enkas për këtë ngjarje. Me këtë rast, Haziri ka falënderuar Japoninë për mbështetjen që i ka dhënë

Gjilanit. "Japonia është vend mik i yni dhe Gjilani është anëtar i Qyteteve të Paqes në Hiroshima në Japoni. Tragjeditë që kemi kaluar na bëjnë bashkë edhe në këto forume. Ne do të punojmë shumë edhe në programe të tjera me Qeverinë e Japonisë në interes të qytetarëve", ka theksuar Haziri.

NJË RRUGË PËR ENVERIN



Nga Bedri ISLAMI

Disa ditë më parë, media të ndryshme të Kosovës, pa sjellë asnjë saktësim informacioni, shkruan se një rrugë në qytetin e Gjilanit është emërtuar "Enver Hoxha". Menjëherë pas tyre reagoi administrata e qytetit dhe saktësoi se asnjë rrugë nuk është emërtuar kështu, duke bërë edhe komentet e saj përse nuk do të ketë një rrugë me këtë emër.

Jo shumë kohë më parë, edhe në Ferizaj, kishte ndodhur e njëjta gjë: Njëra ndër rrugët dytësore ishte emërtuar me emrin e Enver Hoxhës dhe, megjithëse ishte bërë një lojë e gjatë fjalësh, është apo jo e vërtetë, rrua kishte mbajtur gjatë pllakën e saj emërtuese. Si ndodh gjithnjë, pas lajmeve të tilla, të sakta apo jo, vërshojnë komentet, hidhen argumentet pro dhe kundër, sillen në ndihmë fakte e kundër fakte, përcillet një pjesë e së kaluarës dhe mendësi e së tashmes dhe, më pas, me gjithë heshtjen që bie dhe pret rizgjimin, mbetet pyetja: vërtet ka një rrugë të Enverit në Kosovë; përse rizgjimi i emrit të tij, edhe pas kaq shumë viteve vazhdon të jetë një temë e nxehtë, të cilën, sido që ta kapësh, të përvëlton dhe nuk mund të gesh asnjë mendim të njëjtë, pavarësisht kohërave që kanë shkuar, historive që janë thënë dhe mendimeve që janë shfaqur.

Nuk e di se sa është i saktë në këtë rast përkufizimi i Fan Nolit në Librin e tij të njohur për Gjergj Kastriotin, për heronjtë e një vendi, të cilët kalojnë përmes tri fazave, glorifikimit në gjallje të tyre, mohimit të plotë pas vdekjes së tyre dhe rikthimit të vlerave nga brezat e shumë kohërave më pas.

Figura e Enver Hoxhës, në kohëra të ndryshme, ka rrjedhur nëpër qëndrime të ndryshme, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në trojet e tjera shqiptare. Ka qenë gjithnjë një dyzim ndaj figurës së tij, e cila, sado që mund të kenë qenë enigmatike, e pakapshme, e pashfaqur dhe gjithnjë e papritur, përsëri ka sjellë dukuri dhe përplasje, të cilat, jo vetëm në vete, por edhe në shpërthimet jashtë tyre, kanë qenë gjithnjë befasuese, herë-herë tragjike e herë-herë diçka tjetër lloj, mes besimit dhe pritjes.

Në Shqipëri figura e Enverit ka qenë e dyzuar mes asaj që është thënë dhe asaj që është ditur; përkushtimi ndaj tij, qoftë edhe nga figura të njohura të botës së letrave, më shumë ka qenë diktat i kohës, se sa rrjedhë e besimit; njerëzit e përfshirë në rriten e fig-

urës së tij ndoshta ishin të parët që e braktisën atë, e kjo, si mund të ndodhë shpesh, pasi kishin qenë të parët që donin të shkundnin atë mëkatin e padashur drejt së cilit i kishin joshur për të pasur një fillesë lirie diku tjetër. Ishte, si të thuash, haraçi i domosdoshëm që duhej paguar për të pasur një iluminizëm brenda vetes, të ndjeshëm, për të dhënë një dritësim sado të pakët.

Përmbysja e epokës së tij solli njëkohësisht vlerën edhe antivlerën. Nga qëndrimi mrekullisht i arsyetuar, edhe pse kundër figurës së tij, i figurave të shquara si Dritëro Agolli e Moikom Zeqo, të cilët rrëzimin e mitit e gjetën brenda vetes për t'ua dhënë të tjerëve si kumt i mendimit real, është kaluar në skizofreni politike; nga e sakta në hiperbolë marramendëse, që e bënte edhe më të pabesuar krijimin e antimitit.

Jo rastësisht, që në fillimin e goditjes së një figure politike është përfshirë një periudhë e tërë, e cila, edhe pse nuk ishte e ndritshme, sa ishte thënë, nuk kishte qenë aq e zezë sa do e zezonin. Thirrja në ndihmë e një konfiguracioni politik që vinte nga një shtet tjetër, i hasmëruar ashpërsisht, edhe një herë, në vitin 1948, pas një periudhe gati pesëvjeçare besimi, do të ishte shenja e parë e një rrjedhje politike krejt ndryshe. Të gjitha ato që ishin thënë nga qendrat politike serbe, që nga krijimi i PKS-së, si një vepër e tyre dhe deri tek organizimi i pushtetit, si një pasojë e riardhjes së modelit serb në këtë vend, do të shfaqen bujshëm, si gjetje t reja, kur në fakt ato ishin vazhdime që nga fundviti 1948, kur ndarja do të ishte më e thellë se kurrë, kur do të kishte shkrirje të vegjël akujsh, por akullnajat do të mbeteshin dhe, megjithëse vitet e miqësisë kishin qenë më të pakta se sa vitet e armiqësimit, do të përmendeshin gjithnjë ata të parat.

Enver Hoxhës do i mjaftonte t'i saktësoheshin dëmet e mëdha që ishin bërë në jetën e vendit për të saktësuar gjithçka. Kalimi në banalitete njerëzore, me kalimin e epshit të shfryrjes politike, do të sillte edhe fillesat e një nostalgjie të pamend, por që duke harruar të shkuarën, do të mund të bëheshin të kapshme, si një lloj rikthimi i një nënshtetësie që nuk duhet ridhënë.

Mjaftoi vetëm një titull medial, se në një qytet shqiptar një rrugë emërohet me emrin e Enverit, dhe do të fillonte edhe një herë debati që nuk është shuar: e meriton ai një nderim, mund të ketë një rrugë emrin e tij; a do të ketë rizgjim të nostalgjisë për një figurë politike e bashkë me të edhe të tjerëve që u rrinin pranë; përse kjo shfaqet më tepër në Kosovë dhe në vise të tjera, se sa në vendin ku ai drejtoi me dorë të hekurt, si një absolutizëm para historik?

Në Kosovë, mjerisht, ende edhe sot, ka disa rrugë të cilët, edhe pse shkuan kaq vite në pavarësi, ende kanë emërtimin e tyre me emrat e figurave politike sllave, sidomos serbe. Por edhe të shqiptarëve ruajalë, që kanë qenë derivatë të fuqishëm dhe me ndikim të kësaj politike. Disa prej tyre kanë qenë në shumë vite të jetës së tyre politike të afishuar si statura të ashpra të lirisë politike e shoqërore të shqiptarëve në Kosovë, e po ashtu, kanë qenë ashpërsisht kundër bashkimit me shtetin shqiptar, nën çdo regjim të mundshëm.

Ndoshta, më lehtë se kudo tjetër, katarsisi politik në Kosovë ka qenë tepër i sipërfaqshëm; disa nga figurat e pushtetit të mëherëshëm të Kosovës, të njohur si tradicionalistë në linjën e tyre pro shtetit serb, pas luftës, kanë marrë edhe tituj të lartë, janë përcjellë në banesat e fundit me nderime të veçanta; ata kanë pasur e ndoshta kanë edhe sot, poste të larta, këshilltarë politikë të shefave të qeverisë apo të ministrave, megjithëse e gjithë veprimtaria e tyre ka qenë thellësisht e linjës titiste dhe mbështetëse e regjimit të instaluar. Dy nga drejtuesit më të lartë të Lidhjes Komuniste të Kosovës, një derivat i Lidhjes Komuniste të Serbisë, ku ishte qendra e tyre, Mahmut Bakalli dhe Azem Vllasi, kanë qenë në kohë të ndryshme këshilltarë politikë të kryeministrit të Kosovës dhe të ministrit të jashtëm të saj. Duke bërë një paralelizëm vulgar kjo është e njëjtë sikur në periudhën e parë të pluralizmit këshilltarë të Berishës apo të Meksit të ishin Ramiz Alia apo Sofio Lazri.

Këmbëngulësi në Kosovë se një rrugë me emrin e Enverit sillen pikërisht në këto pikëtakime: për deri sa rrugë të ndryshme bartin emërtime të një klase politike thellësisht antikombëtare dhe me dëme të ndjeshme në jetën e shoqërisë shqiptare, atëherë pse të mos jetë edhe një rrugë me emrin e liderit shqiptar të një kohe tjetër, Enver Hoxha?

Komuna e Gjilanit vraoi të theksojë se asnjë rrugë nuk mund të ketë emrin e një diktatori. Nga një çështje administrative ajo e ktheu në një debat politik. Ndoshta, ngutja erdhi për të hequr nga vetja çdo lloj dyshimi që mund të ishte ndaj një vijë sjellje, për më tepër ajo komunë drejtohet nga

një figurë e njohur e LDK-së, Lutfi Haziri, babai i të cilit ka qenë dikur pjesë e ndjeshme e lëvizjes çlirimtare që kishte si një nga simbolet e saj edhe figurën e Enver Hoxhës.

Shpesh herë, jo pak njerëz, më kanë pyetur, përse në Kosovë ndjenja pro Enverit është më e ndjeshme se sa në Shqipëri; përse atje organizohen konferenca politike, takime jubilarë, botohen libra, janë organizuar shoqata në emrin e tij dhe kjo nuk ndodh edhe në Shqipëri.

Nuk e di mirëfilli se ku është më e ndjeshme rrita e qëndrimit ndaj tij, por e di mirëfilli se njëzet vite më parë, ngritja e një teme të tillë, jo vetëm do të ishte tabu, por do të dukej edhe çmenduri e radhës. Nëse sot ka dalë nga radhët e "çmendurisë, fajtor nuk është një figurë e larguar prej shumë kohe nga jeta, as një lëvizje nostalgjikësh, të cilët, edhe kur shkojnë në varrezat e dëshmorëve tërheqin këmbët zvarrë të lodhur nga mosha. Politika e prapshtë sjell në relievin e kujtesës edhe atë që mendon se e ke mundur përfundimisht.

Në Kosovë janë disa shkaqe që e bëjnë më të ndjeshëm këtë gjendje.

Shumë vetë në Kosovë, ende , edhe sot, e kanë të vështirë të kuptojnë pse shteti shqiptar i tri dekadave të fundit, njerëzit drejtues të politikës atje, ende kanë nostalgji për kohën e Titos kur e krahasojnë atë me regjimin e Enverit. Deklaratat e herë pas hershme, qoftë të Nanos, kur ishte ndër Njëshat e politikës, qoftë të Berishës, kur i a sillnin ngushtë se, qeveria e Titos ishte shumë m liberale se sa ajo e Enverit, janë të pakuptueshme për to.

Ata sjellin shifra dhe këto shifra janë fakte, janë njerëz. Në periudhën e regjimit të Titos në shtetin jugosllav janë rreth 42 mijë shqiptarë të vrarë, që nga viti 1944 e deri në vitin 1981, kuptohet jo me të njëjtën shtrirje në të gjitha vitet. Masakrat e mëdha, publikisht të njohura, si ato të vitit 1945 apo 1946, të aksionit për mbledhjen e armëve etj; goditjet e grupeve të qëndresës, ku është emblemë ajo e Shaban Polluzhës, janë aktet më të mëdha të krimit në pasluftë, që u përsëritën në vitet 1998 -1999.

Që nga paslufta e deri në qershor 1999 janë të burgosur politikë shqiptarë mbi 345 mijë vetë, çka

do të thotë se në të gjitha vitet burgjet serbosllave kanë qenë të mbushur me shqiptarë.

Ata nuk e kuptojnë dot se si një shtet , i cili duhet ta quante veten liberator, edhe një masakër të njohur si ajo e Tivarit, e pranuar nga vetë forcat serbe si akt i tyre hakmarrës ndaj "ballistëve shqiptarë", bëhet shkak i ngritjes së një grupi hetimor parlamentar, që akuzon shtetin shqiptar, në të njëjtën linjë me politikën e sotme serbe, duke i hequr atij shteti pelerinën e një faji tragjik dhe duke e vendosur mbi shtetin amë. Dëshmitarë, ende të gjallë edhe sot e kësaj dite, nëse pyeten qetësisht, pasi bëjnë be "pasha atë kohë kur kemi qenë Shqypni", të tregojnë se vetëm ardhja e brigadave shqiptare ndaloi krimet e planifikuara serbe në vitin 1945; ndërsa tani, për hir të një politike, haptas mbështetëse të politikës serbe, krijohet alibia e rreme për serbët dhe fajësohet qeveria shqiptare e pas luftës.

Kam pasur fatin e pashoq që në një moment të jetës sime të jem mik e shok i shumë të burgosurve politikë, shqiptarë të Kosovës, të cilët, edhe pas burgimeve të rënda, nuk e ndaluan aktin e tyre çlirimtar. Përjetimet e atyre që kanë qenë të burgosur në Goli Otok, në Stara Gradishkë, veçanërisht në burgjet serbe, torturat e hequra me ditë, me javë e me muaj, rrahjet vandale, sidomos nga ish-policë dhe sigurimsa shqiptarë, janë të llahtarshme. Shumë kanë vdekur në tortura.

Klasorja rëndonte edhe mbi familjet e tyre. Kishte fise të tëra të lëçitura, të mbyllur në kullat e tyre si në burgjet e vetvetes; largimet nga puna ishin të zakonshme. Xheva Krasniqi, për shembull, njëra ndër figurat më mitike të Kosovës së sotme, megjithëse e diplomuar dy herë, si mësuese e gjuhës shqipe dhe si juriste, do të flakej nga puna, sapo i fejuari i saj, Fehmi Lladrovci do të burgosej si drejtues politik i lëvizjes çlirimtare. Kjo ndodhte me të gjithë. Në fakt, ata ishin të lëçitur brenda lëçitjes së tyre.

Në këtë lëçitje, e cila ishte herë-herë dërmuese, i vetmi zë, që mund të ishte real apo edhe mund t'u dukej, vinte nga shteti shqiptar. Në mes dy zgjedhjeve; mes shtetit titist apo shtetit komunist të Hoxhës, ata, pa asnjë ngurrim, zgjodhën shtetin shqiptar. (Vijon)



Presidenti i Zimbabve i shpëton atentatit

HARARE, 24 QERSHOR - Presidenti i Zimbabvesë, Emmerson Mnangagwa, ka shpëtuar pa pësuar lëndime, pas shpërthimit të një bombe në qytetin Bulawayo. Në videot e shfaqura shihet se si një

shpërthim ka ndodhur në një stadium në kohën kur presidenti po largohej nga skena, pasi u ishte drejtuar mbështetësve të vet. Televizioni shtetëror ka raportuar se presidenti nuk ka pësuar lëndime,

por zëvendës-presidenti Kembo Mohadi ka pësuar një lëndim në këmbë. Presidenti Mnangagwa ishte duke marrë pjesë në një tubim partiak përpara zgjedhjeve që do të mbahen më 30 korrik.



Shpëtohen 100 migrantë në Detin Mesdhe

TRIPOLI, 24 QERSHOR - Rojet tregtare të Libisë kanë njoftuar se kanë shpëtuar rreth 100 migrantë nga Afrika, përfshirë dhjetëra gra dhe fëmijë, në brigjet e saj në Detin Mesdhe. Zëdhënësi i rojeve bregdetare, Ayoub Gassim, ka theksuar se

anija me të cilin po udhëtonin migrantët u ndal sot në brigjet e qytetit Zliten. Ai ka thënë se migrantëve u është dhënë ndihmë mjekësore dhe ata janë dërguar në bazën detare në Tripoli. Libia është pikë e rëndësishme e transitit në Evropë për

migrantët që po ikin nga varfëria dhe lufta civile në vendet afrikane. Kohët e fundit, me ndihmën e evropianëve, autoritetet libiane kanë rritur përpjekjet për ta frenuar kalimin ilegal të migrantëve për në kontinentin evropian.

Tsipras mban premtimin, vendos kollaren

ATHINË, 24 QERSHOR - Disa vjet më herët, pasi kishte marrë drejtimin e Greqisë me synimin për t'i dhënë fund krizës së borxhit, kryeministri Alexis Tsipras kishte bërë një premtim të çuditshëm. Ai pati thënë se pasi të arrinte këtë qëllim, do të fillonte të vishte kollare, një aksesori që nuk është se e pëlqen dhe përdor as në takimet zyrtare. Ministrat e financave të Eurozonës i ofruan Greqisë një shtyrje dhjetëvjeçare dhe zgjatje të afatit për një pjesë të madhe të kredive të kaluara, si dhe 15 miliardë euro kredi të re, për të siguruar që Athina të mund të qëndrojë në këmbët e veta pasi të dalë nga ndihma e BE-së në gusht. Këtë

lajm Tsipras i e priti me humor e qetësi, ndërsa në takimin me aleatët politikë të tij në Athinë, mbajti premtimin e dhënë dhe vendosi një kollare. "Sot është një ditë e rëndësishme për të gjithë, por para së gjithash u takon atyre që për tetë vjet u goditën keq nga kriza, për ata që panë një jetë të tërë të shkatërruar dhe ata që mbanin barrën për vendin", ka deklaruar Tsipras. Kriza përfshiu Greqinë në vitin 2010, ndërsa që atëherë ekonomia në vend u tkurr me 1/4-tën, papunësia u rrit ndjeshëm dhe pagat e pensionet u ulën për 40 për qind, ndërsa u kërkuan tri kredi të mëdha për të shpëtuar.



Presidenti rumun thotë se do të garojë edhe për një mandat



BUKURESHT, 24 QERSHOR - Presidenti i Rumanisë, Klaus Iohannis, ka bërë me dije se do të rikandidojë edhe për një mandat pesëvjeçar, në zgjedhjet që do të mbahen vitin e ardhshëm. "Jam i përkushtuar për të garuar edhe për një mandat si presidenti i Rumanisë", ka thënë ai në një vizitë më 23 qershor në Sibiu, qytetin e tij të lindjes. Centralisti Iohannis, 59 vjeç, me etni gjermane, u bë president i vendit më 2014, pasi garojë në zgjedhje me platformë kundër korrupsionit. Iohannis akuzon

partinë në putet, Partinë Socialdemokrate (PSD), se po tenton ta dobësojë luftën kundër korrupsionit, duke bërë presion mbi sistemin gjyqësor dhe duke zbatuar politika të gabuara fiskale. Lideri i PSD-së, Liviu Dragnea, më 21 qershor u dënua me tre vjet e gjysmë burgim nga Gjykata Supreme, nën akuzë se ka nxitur persona të tjerë të keqpërdorin detyrën zyrtare. Ai mohon të gjitha akuzat dhe po vazhdon të qëndrojë në burg, duke pritur që lënda e tij të dalë para një gjykate të apelit. Mijëra rumunë më 23 qershor

kanë protestuar para Qeverisë në Bukuresht dhe në qytete të tjera në mbarë vendin, kundër amendamenteve kundërthënëse që mbështeten nga PSD për ligjet për drejtësi dhe për Kodin Penal, duke thënë se me këto amendamente bëhen hapa prapa në luftimin e korrupsionit. Presidenti rumun, Iohannis, Komisioni Evropian dhe Departamenti amerikan i Shtetit kanë kritikuar ndryshimet e propozuara në gjyqësor, duke thënë se këto ndryshime dëmtojnë sundimin e ligjit.

Mirëpritet heqja e ndalesës për gratë shofere në Arabi Saudite

RIAD, 24 QERSHOR - Autoriteti më i lartë fetar i Arabisë Saudite ka mirëpritur heqjen e ndalesës për ngasjen e makinave nga gratë, ndalesë që ishte në fuqi prej disa dekadash.

Gratë në Arabinë Saudite nga sot mund të drejtojnë makinat, një veprim ky që është në kuadër të disa vendimeve për liberalizimin në mbretërinë konservatore. Këshilli i Dijetarëve të Lartë, një organ pro-shtetëror, tha se dekreti mbretëror, që lejon gratë të ngasin


makinat, është në interes të shoqërisë.

Mbreti Salman ka lëshuar dekretin në shtator të vitit 2017, pas një sërë fushatash të grave saudite dhe grupeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që dënuan këtë ndalesë dhe e cilësuan si formë të shtypjes. Dekreti konsiderohet si pjesë e procesit të liberalizimit, që po ndërmerret Princi i Kurorës Mbretërore, Muhammad bin Salman. Ky dekret hyri në fuqi sot dhe u mundëson grave që të mos

varen nga burrat apo pjesëtarët e tjerë të familjes për transport automobilistik.

Samira al-Ghamdi, 47 vjeçe, një psikologe nga Jeddah, që ishte ndër gratë e para saudite që mori patentë-shoferin, tha se "ne jemi gati dhe kjo do të na ndryshojë krejtësisht jetën".

Pavarësisht të drejtave të reja që u janë garantuar grave në Arabinë Saudite, gratë vlerësohet se janë të shtypura në këtë shoqëri të dominuar nga burrat.



Kundrim

NJË ROMAN JOHISTORIK, KU NDODH HISTORIA

(Gazmend Bytyçi, "Mallkimi i shekujve", KL 'De Rada', Ferizaj, 2018)

Sulejman DËRMAKU

Pas romanit të parë "Karbaina e gjyshit", autori Gazmend Bytyçi vjen me romanin e tij të dytë, "Mallkimi i shekujve". Me rastin e përrimit të romanit të parë, pata dashur ta citoja profesorin tim të nderuar dhe shkrimtarin, gazetarin e publicistin Ramiz Kelmendi. Ai shumë shpesh, në rastet kur në hapat e parë ia mbushte mendjen vepra e një autori, në çfarëdo fushe, thoshte: Mbajeni mend këtë emër! Megjithatë, nuk e thashë atëherë! Duke e cituar profesorin tim, e thashë me rastin e përrimit të romanit të tij të dytë të Gazmend Bytyçi: Mbajeni mend këtë emër!

Ndikime tragjike mbi fatin tonë kolektiv

Dhe, kujtdo që e merr në dorë për ta lexuar këtë roman, doemos që i imponohet një krahasim ndërmjet këtyre dy veprave të këtij autori. Derisa në romanin e tij të parë bota e shpërfaqur është e kufizuar brenda një periudhe disadekadëshe të shekullit XX, në romanin "Mallkimi i shekujve" bota na shpërfaqet që nga thellësia e lashtësisë së shekujve e deri në ditët e sotme, me tërë kompleksitetin e saj, me tërë spektrin, kryesisht të mugët, me tërë ato rrjedha nga më të ndryshmet, që jo rrallë patën dhe ndikime tragjike mbi fatin tonë kolektiv.

Nëse dallon në këtë aspekt ky roman nga i pari, a ka ngjashmëri ndërmjet tyre? Ndonëse në rastin e parë duket se kemi të bëjmë me subjekte të ndryshme të romaneve, megjithatë, me plot gojën mund të themi se edhe ky, si i pari, në instancë të fundit, subjekt themel ka jetën luftë dhe luftën jetë dhe gjakimin e vazhdueshëm të lirisë, asaj së mirëfilltës. Në saje të përvojës së shtresuar të autorit në luftën e fundit për liri, tërë romanin e përshkon pikërisht kjo frymë shumëshkullore e përpjekjeve tona ndër mote. Dallimi i vetëm qëndron në faktin se, derisa në romanin e parë ngjarjet kryesisht janë reale, në këtë roman, me mjeshtëri e sens të mrekullueshëm, me një gjuhë të shpirtit e të qiellit, siç do të thoshte Osho, janë gërshetuar fikcioni e realiteti, imagjinaria e realja, sa nganjëherë kufiri ndërmjet tyre shkrihet tërësisht, aq natyreshëm, sa që ato kompensojnë njëra-tjetrën, siç zaten ndodh edhe në realitetin jetësor, i cili nuk do të ishte i plotë pa fiktiven, pa ëndrrat, pa shpresën, të cilat, thënë figurshëm, janë erëza, që

jetës i japin shije e kuptim.

Të mos dish për jetën e njerëzve më të famshëm të lashtësisë, do të thotë të vazhdosh në një gjendje të fëmijërisë gjithë kohën, pohon Plutarku. Mbase duke mos dashur që autori të mbetej në një gjendje të këtillë fëmijërie, as ta lërë në këtë gjendje kryepersonazhin, Gurin, në roman, duke u trajtuar rrjedha jetësore e këtij, por edhe e shumë personazheve të tjera, spontanisht trajtohet Leka i lashtësisë sonë dhe vetë jeta në tërësinë e saj, përbrenda dy skajeve: lindje-vdekje, shpesh madje, siç e thamë, edhe duke u shkrirë këto skaje njëri në tjetrin. Në roman sikur është pasqyruar tërë e kaluara jonë si kolektivitet, tërë krusma jonë kolektive ndër mijëvjeçarë, që nga mugëtirë e shekujve tanë paganë, nëpër kohë në të cilat, siç thuhet në roman: "Ndryshe nga herë të tjera, për lutje tani po shkonin vetëm burrat", e deri në ditët e sotme, me të gjitha katrahurat, kundërthëniet e ndeshtrashat që populli ynë i ka përjetuar. Në kontekst të propagandimit të fesë, përbrenda faqeve të romanit, ndeshim Sadik agën të Belishëve i cili është prototipi i shërbyesit të armikut. E, gjatë historisë sonë, mjerisht, patëm e po dalin shumë sadikër, të cilët gjithmonë kahun e historisë e drejtuan në interes të armikut.

Në kërkim të gjurmëve tona

Rrëfimi romanor, që na jepet me diskurs të tri vetave dhe të tri kohëve narrative, nis në varrezat e fshatit të lindjes së kryepersonazhit Guri, i mëhallës së Gashëve, me ekspeditën provokuese të masakruësve tanë, që kishin ardhur kinse për pelegrinazh, në kohën e tashme, për t'u kthyer pastaj narracioni, retrospektivisht, në kohën e shkuar, që nga fëmijëria e Gurit dhe ekspedita arkeologjike, e cila sapo has gjurmë të rrënjëve tona, e urdhëruar nga lart, i mbulon ato dhe ikën nga kishte ardhur. Nëpërmjet diskursit narrativ të rrjedhës jetësore të kryepersonazhit dhe ambicieve për zbulimin e gurit me shtatë fytyra, si amanet fëmijërie, dokumentit sekret, pengsave që atij ia vështirësojnë ecjen, ia rrënojnë ëndrrat si edhe shokut të tij, Bekimit, pasqyrohen ngjarje të shumta të historisë sonë, që nga lashtësia deri në ditët e sotme ose, thënë më mirë, në mënyrë retrospektive, që nga ditët e sotme e deri thellë në lashtësi. Dhe, fati jetësor individual i këtyre dy personazheve, si dhe i dy pleqve të nacionaliteteve të



ndryshme, Bardhit e Mikës, nuk është këtu thelbësor në vetvete, ai është vetëm simbol, vetëm transmision, thënë figurshëm, nëpërmjet të cilit lidhen idetë dhe kohët, duke zberthyer dhe duke u përpjekur për t'i dekoduar lëvizjet dhe kodet historike e morale, duke kërkuar çelësin e rrugëve të reja, për ta dëshmuar autoktoninë tonë, përherë të mohuar nga pretenduesit e trojeve tona, për ç'arsye mbreti kishte angazhuar shkencëtarin me nam, kroato-hebreun Milan Shuflaj, i cili ishte intriguar nga historia e ilirëve, siç pohon autori Bytyçi, porse edhe zhgënjimet, rëniet e ngritjet njerëzore.

Ndërmjet Bardhit e Mikës, dy pleqve të nacionaliteteve të ndryshme, të cilët ishin shoqëruar që nga fëmijëria, ndonëse në një atmosferë tepër të nderë e armiqësore, pas tërë atyre vrasjeve, masakrave dhunimeve, djegieve e rrënimeve nga militarë, paramilitarë e milicë serbë, megjithatë zhvillohet një dialog tepër human, tepër i njerëzishëm, shoqëruar me lot, që pleqve u përshkojnë rrudhat e moteve dhe puqen në mjekër, i cili prek në shpirt çdo lexues, që sadopak ka përjetuar ose ka mësuar për ato vite kur fqinjët tanë sikur kishin harruar madje edhe që ka Zot dhe mbi ne kishin ushtruar të gjitha të zezat që mendja e shëndoshë as mund t'i imagjinojë, e le më t'i

kapë.

Bekimi, shoku i Gurit, tashmë ka mbaruar luftën e vet. Guri nis një luftë tjetër, specifike, në të cilën hyn edhe Bekimi. Bekimi luftoi për shporrjen e pushtuesit, Guri, ndërkaq, bën luftë për ndriçimin e rrënjëve tona aq të mohuara nëpërmjet dokumentit sekret që do ta zhdavarisë errësirën e shekujve, jehona e së cilës vjen si mallkim deri në ditët tona. Midis luftës së tyre, është një luftë tjetër në roman, që transponohet nëpërmjet luftës për jetë të rrogëtarit pa emër dhe lagjeve që gdihen me hënë, duke braktisur diellin, simbolin e dikurshëm të genies sonë.

Një jehonë metaforike nga thellësi lashtësie

Përgjatë tërë romanit, si një mit, na shoqëron numri 7 dhe pothuajse gjithçka lidhet me këtë numër. Cili është misteri i këtij numri? Përse ky duket të ketë qenë, mbase dhe mund të jetë, numri më i rëndësishëm? Cili është sekret i tij i shenjtë?

Që nga arianët dhe babilonasit e lashtë, te hindusët, japonezët e persët, e deri te hebrenjtë, krishterët e myslimanët, praktikisht nuk ka as një të vetme kulturë në të cilën numri 7 nuk luan një rol të rëndësishëm kozmik. As ekziston religjion në të cilin numri 7 nuk është pozitiv, numër

i shenjtë.

Numri 7 është një nga numrat më magjikë dhe më të shenjtë për të cilët di raca njerëzore. Pareshtur përsëritet në të gjitha tekstet religjioze dhe vihet në pedestal. Së këndejmi edhe përgjatë tërë romanit del 7-ta e famshme, në formë orësh, ditësh, vitesh, fytyrash...

Po, mallkimi, që e ndeshim jo vetëm në titull të romanit të autorit Bytyçi, si të shpjegohet, vallë? Kush kë mallkoi? Përse shekujt e gjëllimit të racës sonë qenë dhe, mjerisht, po vazhdojnë të jenë të mugët, për të mos thënë të errët e të mallkuar? Ç'mallkim është ky?

E, pra, nga e tërë përmbajtja e romanit, ndonëse jo drejtpërdrejt, një jehonë metaforike nga thellësi lashtësie sikur pareshtur përsëritet: NE! Po, vetë ne! Me veprimet dhe mosveprimet tona! Mid'hat Frashëri, që në krye të herës, paskësh thënë: Shqiptari prej natyre është kotësidashës, plot vanitet dhe egoizëm. Nuk i pëlqen kurrë të shohë dhe të njohë fajin dhe të metën e tij: i pëlqen kurdoherë të ngarkojë një tjetër. Zaten këtë e pohon edhe Guri, i cili në bibliotekën mbretërore po kërkonte dokumentin sekret. Kur e pyet shoku i tij, Bekimi, në kishte gjetur gjë, ai thotë: Mallkim, mallkim, ja çka gjeta. Gjeta mallkim nga historia, asgjë më shumë se mallkim. Tema e romanit është aktuale, e kohëve të sotme, por gjithnjë me sfond lashtësinë, duke krijuar kështu një ndërlidhje të natyreshme të periudhave të ndryshme të historisë sonë, që nga shekuj antikë. Përgjatë tërë veprës, ndonëse tërthorazi, është e pranishme edhe lufta, që nga koha e Lekës së Madh, e Skënderbeut, deri në luftën e fundit, pjesëmarrës i së cilës ishte Bekimi, që tërë kohën e shoqëron Gurin. Ky nuk kishte pasur guximin të rrokte armët si shoku i tij, porse tashti sikur po vazhdonte një luftë tjetër, natyrisht në një formë tjetër, specifike...

Shpirti i njeriut është më i rëndësishëm se forca fizike, dhe natyra shpirtërore e një kombi është më e rëndësishme se pasuria e tij, thotë Ajzenhauer. Pikërisht mesazhin e kësaj sentence duket ka parasysh edhe Guri, i cili me ngulm do ta vërë në shërbim të kombit të vet tërë potencialin e shpirtit e të mendjes, ani pse do t'i kushtojë shumë, bashkë me shokun e tij, Bekimin.

Duke pasur parasysh të gjitha këto, edhe pse romani nuk mund të quhet historik, praktikisht në roman ndodh historia, duke u bërë kështu edhe vetë romani historik.

E rrallë

250 priftërinj kërkojnë armë zjarri

Më shumë se 250 udhëheqës fetarë në Filipine duan leje për të zotëruar armë, mes rritjes së vrasjes së priftërinjve. Zyrtarët më të lartë katolikë, megjithatë, kërkojnë që kleri të jetë gati të "përballet me vdekjen dhe rrezikun" pa pasur nevojë për armë.



FOTO E DITES



Një tetëvjeçare në provincën veriore siriane të Idlibit ecën duke përdorur këmbët e protezave të bëra nga babai i saj. /AFP/

E jashtëzakonshme

Hyrja falas në park lojërash për gratë që peshojnë mbi 61 kg

Në Kinën Qendrore, në parkun tematik "Tang Paradise", për tri ditë rresht, 168 gratë e para që peshonin mbi 61.8 kilogramë (mbi peshë në krahasim me standardin e vendit) kanë



hyrë falas në këtë park. Kjo ide në rrjetet sociale është konsideruar fyese.

BARSOLETA E DITËS



Infermierja: I ke marrë barnat, fashat, shiringat dhe infuzionet?
Pacienti: Po.
Infermierja: Jastëkun dhe çarçafin?
Pacienti: Po.
Infermierja: Po ky personi me ju, kush është?
Pacienti: Ky është mjeku. E kam sjell nëse nuk keni.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesly, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.




Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p>DASHI Do të vini në zbatim gjithçka që keni mësuar gjatë këtyre ditëve. Sot do të nevojiten patjetër për të zgjidhur një situatë ngërçi.</p>	 <p>DEMI Nëse nuk dëshironi të keni kundërshtime nga të gjithë sot, mundohuni të shpjegoheni sa më qartë për gjërat dhe detyrat që ju kërkojnë.</p>	 <p>BINJAKËT Ka disa rrugë ku ju mund të shkëlqeni në karrierën tuaj personale, por ka rrugë të tjera të cilat mund të bëjnë persona afër jush të triumfojnë.</p>	 <p>GAFORRJA Disa argumente të caktuara sot mund të sjellin debate të ndezura në familje. Është mirë që çdo pjesëtar ta dëgjojë tjetrin përpara se të flasë.</p>	 <p>LUANI Keni përballuar shumë sfida kohët e fundit dhe kjo ju ka dhënë mjaft vetëbesim. Mundohuni që në çdo fushë të jeni në të njëjtën frymë.</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Një situatë emergjente dhe që e kishit neglizhuar sot do t'ju shtrengojë të rrii shumë më gjatë në punë.</p>
 <p>PESHORJA Dita do të nisë qetë, por disa të papritura do ta ndryshojnë të gjithë rrjedhën e saj duke ju detyruar të anuloni disa plane tuajat.</p>	 <p>AKREPI Keni marrë përsipër disa aktivitete të pazakonta për ditën e sotme dhe do të shikoni që mund të jetë pak problem për t'i finalizuar.</p>	 <p>SHIGJETARI Nuk po merrni vendimin më të lehtë nga ana sentimentale, por do t'i bëni shumë mirë një personi të afërt me ju.</p>	 <p>BRICJAPI Nëse sot nuk ju pëlqen të debatoni lidhur me një problem të caktuar keni gjithë të drejtën të tërhiqeni dhe të tregoheni indiferent.</p>	 <p>UJORI Rreth jush janë krijuar pritshmëri të caktuara sepse keni treguar që mund t'i realizoni dhe të bashkëpunoni në kohë rekord për gjëra të ndryshme.</p>	 <p>PESHQIT Ditët e fundit jeni në pritje të një lajmi të rëndësishëm që do të arrijë vetëm sot. Edhe pse do të zhgënjeheni pak do të rikuperoni rrugës.</p>

Cat Deeley bëhet sërish nënë



Cat Deeley lindi fëmijën e dytë. 41-vjeçarja dhe burri i saj, Patrick Kielty, u bënë me një djalë, raporton "People". Çifti e

emëroi djalë James Patrick Kielty. Çifti, të cilët janë martuar që nga viti 2012, tashmë janë prindër të një djalë dyvjeçar me emrin Milo.



Hyland shtrohet në spital

Ylli i serialit "Modern Family", Sarah Hyland, ka shokuar fansat me një fotografi të fytyrës së saj tërësisht e ënjtur, pasi tregoi se është shtruar në

spital që një javë. Përmes një postimi në "Instagram Hyland", 27-vjeçarja u tregoi fansave se kishte ndërprerë punën menjëherë dhe ishte shtruar në spital.

Nick Jonas dhe Priyanka Chopra zyrtarizojnë lidhjen



Nick Jonas dhe Priyanka Chopra duket se kanë zyrtarizuar marrëdhënien e tyre. Pas një fundjave ku i njoftoi prindërit e Jonas, në dasmën e kushëririt të tij në New Jersey, Chopra tha se është koha ta njoftojë

të dashurin e saj me të gjithë. Sipas "ET", dyshja i kanë hipur avionit dhe janë nisur për në Indi, ku Jonas do ta njoftojë nënën e Choprasit. Lidhja e çiftit po bëhet serioze dhe, sipas burimeve të "ET", ata janë më të lumtur se kurrë më parë.

Arrestohet reperi i njohur



Reperi J Hus është arrestuar dhe akuzuar për mbajtjen e një thike në Londër. Artisti, emri i vërtetë i të cilit është Momodou Jallow, u arrestua më 21 qershor nën dyshimin se kishte një thikë me vete. Kjo

ndodhi pasi policia ndaloi një automjet në afër një qendre tregtare. Reperi më pas u paraqit në gjykatë ditën tjetër. Ai aktualisht është në paraburgim ku do të qëndrojë deri më 20 korrik për një seancë gjyqësore.

Ana, një histori tragjike dashurie

"Po guxoj të të kërkoj të ma thuash prerë çfarë mendon për dashurinë tonë. Nevoja më shtrëngon ta di përgjigjen tënde, duke qenë që kam një vit që jam plagosur nga dashuria dhe ende nuk jam i sigurt nëse kam apo jo një vend në zemrën tënde".

Mbreti Henri VIII i Anglisë donte të dinte me padurimin se çfarë zemra e Ana Bolenës mendonte për të. Dhjetëra letra ai nisi në adresë të gruas që më vonë do të shënjonte historinë më dramatike të dashurisë në oborrin anglez. Historia e tyre është si në përralla. Mbreti i Anglisë, i cili ishte martuar në atë kohë, ra në dashuri me një shërbëtoren e tij, që quhej Ana. Ai e donte aq shumë divorcin, me qëllim që të mund të martohej me Anën, sa që hyri në konflikt me Kishën Katolike (që

shumëkush, në atë kohë, besonte se kontrollonte fatin e shpirtit tonë të pavdekshëm).

Edhe pse martesë e tyre do të përfundonte në tragjedi, dashuria e tyre tronditi themelet e qiejve. Ana Bolena u bë Mbretëreshë pas martesës si gruaja e dytë e Mbretit Henri VIII dhe mbretëroi nga viti 1533-1536; gjithashtu ishte dhe Markeze e Pembroke-s. Historia e saj shumë e përfolur mbetet një nga historitë më dramatike të Anglisë, pavarësisht se historianët anglezë thonë se ishte nga Italia, ajo mbetet një personazh ku familja e saj arbërore nga Bolena e Vlorës, ka ikur nga Arbëria në Itali pas vdekjes së Gjergj Kastriotit- Skënderbeu.

Ardhja e familjes së saj të pasur në Angli nuk dihet mirë. Mbreti Henri pati një dashuri të

sëmurë për të, kjo gjë shihet dhe nga letrat e dashurisë që janë të pafundme në arkiva. Aq sa iu errën sytë nga fjalët dhe besoi se mund ta kishte tradhtuar duke i prerë kokën. Kjo histori tragjike vijon të frymëzojë artistët që kanë shkruar opera për të, apo libra. "E dashura ime, zemra ime dorëzohet në duart e tua, duke u lutur ta mbash aty përgjithnjë. Sa e lëndon zemrën time mungesa jote. Sa të gjata janë ditët dhe sa i largët duket dielli, dhe kurrë më parë nuk më janë dukur më të nxehta sesa tani nga mungesa jote. Po ju dërgoj imazhin tim me një byzlyk ta mbash në duar e të më kujtosh gjithnjë...Uroj të të pëlqejë", shprehej Henri në një nga letrat para se të lidhnin kurorë.

(gazeta-Shqip.com)



Mata Hari, jeta plot tortura me bashkëshortin e parë



Ai quhej Rudolf Makleon dhe ishte i pari që ra në dashuri me gruan që do të kthehej në simbol të bukurisë së inteligjencës botërore. Atëherë ajo ishte e ndrojtur dhe Makleon nuk mund ta mendonte se gruaja që shërbente darkën në tryezën e shtëpisë së tij, do të mund të fuste në kurth burrat më të fuqishëm të botës.

Ai ra menjëherë në dashuri me bukurinë e saj dhe u martua pa u menduar gjatë. Vajza e rritur jetime e pa këtë martesë si një mënyrë për të ndërtuar familjen e ardhshme. Një herë duke lexuar gazetën, ajo hasi një njoftim për martesë nga një kapiten i ushtrive koloniale. Makleon e kishte parë gazetën si një mënyrë për të gjetur një grua të denjë. Kur u takuan ai e pëlqeu

menjëherë. Ajo do të martohej me të por jeta bashkëshortore do të kthehej në një ferr.

Pas martesë ai filloi të sillej gjithnjë e më keq. Shërbëtori i tij, të cilin e kishte shtyrë deri në dëshpërim u përpoq që t'i helmonte fëmijët. Djali Norman vdiq ndërsa e bija Gertruda, mezi arriti të shpëtojë. Për të qarkullojnë shumë legjenda, por disa thonë se ka vdekur gjatë viteve të Luftës së Parë Botërore. Të tjerët thonë se ka shpëtuar dhe ka jetuar në Xhakarta ku është marrë me spiunazh njëllor si e ëma. Gjatë luftës së Koresë, thonë se është kapur nën emrin Vilhelmina Van Diren dhe është pushkatuar për spiunazh.

Por a ishte vërtetë kjo vajza e Mata Harit? Kjo pyetje nuk mori

kurrë përgjigje. Gjithsesi Margaret u nda nga Rudolphi dhe gjeti punë si kalorëse në një cirk parizian, më pas kaloi në estradë. Kishte një farë pamjeje enigmatike si lindore, zotëronte plasticitet dhe mbi të gjitha kishte njohuri në fushën e valëve dhe të ritualeve të banorëve gjysmë të egër të Javës dhe të Sumatres ku kishte jetuar me bashkëshortin e parë.

Drejtori i cirkut e ndihmoi të futet në jetën mondane dhe salonet e saj. Mori emrin ekzotik Mata Hari që do të thotë "syri i mëngjesit", pasi askush nuk e di me saktësi. Sipas të dhënave ajo është bërë spiune e gjermanëve përpara luftës së vitit 1914 menjëherë pas ndarjes me kapitenin Makleod, atëherë kur kishte nevojë për mjete vetjake sado

modeste. Në favor të këtij versioni qëndron fakti se figuron si agjenti H-21 në shërbimin e fshehtë gjerman, dhe me gjermanin H shënoshin agjentët e vjetër.

Sipas një versioni tjetër, në korrik të vitit 1914, Mata Hari ka shkuar nga Parisi në Gjermani dhe aty e zuri lufta. Kërcimtarja është parë në një lokal duke ngrënë mëngjes me kreun e policisë së Berlinit dhe ky ka qenë i vetmi fakt që vërteton se ajo ka punuar për të. Margaret

Gertruda Cele e njohur më vonë si Mata Hari lindi në 7 gusht të vitit 1876 në qytetin holandez të Lauverden, në familjen e një mjeshtri kapelesh. I ati falimentoi shumë shpejt dhe s'është ku u zhduk, e ëma vdiq. Jetimen e mori në edukim një xhaxha. Vajza rritej, por përherë dhe më tepër jeta e mjerë provinciale e mërzieste. Historia e jetës së saj vijon të jetë frymëzuese për biografët apo ata që eksplorojnë botën e spiunazhit.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SPAIN - MOROCCO

1

SAUDI ARABIA - EGYPT

1

IRAN - PORTUGAL

2

Gërbeshi: Do ta mposhtim Santa Coloman

Drita të martën debutojnë në Ligën e Kampionëve, kurse Fidan Gërbeshi është optimist se do të shënojë fitore. "Ne kemi respekt për klubet që janë pjesëmarrëse në Ligën e Kampionëve. I kemi shitur disa video dhe e kemi analizuar këtë kundërshtar, por jemi optimist se mund të shënojmë fitore", ka thënë Gërbeshi



© VISAR BEQIRI

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Mbrojtësi Fidan Gërbeshi ka shprehur optimizëm për ndeshjen e parë historike që Drita e zhvillon në kuadër të Ligës së Kampionëve ndaj FC Santa Coloma. Ai ka thënë të dielën për "Epokën e re" se gjilasanit janë përgatitur mirë për këtë ndeshje dhe do ta prezantojnë futbollin e Kosovës në mënyrën sa më të mirë. "Ne jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje historike për klubin, qytetin dhe Kosovën.

Normalisht se kemi emocione, sepse është ndeshja e parë në arenën ndërkombëtare dhe përgjithësisht është më e madhe, por besoj se do të bëjmë një paraqitje të mirë dhe prezantim të shkëlqyeshëm", ka thënë Gërbeshi. Drita ka zhvilluar edhe seancat e para stërvitore në Gjibraltar dhe futbollistët kanë treguar formë të mirë. Gërbeshi duke folur për skuadrën kundërshtarë, ka thënë se e kanë analizuar dhe se është një kundërshtar që mund të mposhtet pa ndonjë problem të madh. "Ne kemi respekt për klubet që janë

pjesëmarrëse në Ligën e Kampionëve. I kemi shitur disa video dhe e kemi analizuar këtë kundërshtar, por jemi optimist se mund të shënojmë fitore", ka shtuar ai.

Skuadra e drejtuar nga Bekim Isufi do të përballet me FC Santa Coloma të martën nga ora 17:30 në "Victoria Stadium", Gjibraltar. Përveç kampiones së Kosovës, Dritës, në arenën ndërkombëtare do të paraqitet edhe skuadra fituese e Kupës, Prishtina. Kryeqytetasit do të luajnë në Ligën e Evropës ndaj FC Europa.

SHKURT

Karateistët përfundojnë garat në "Tarragona 2018"

Ekipi i karatesë së Kosovës i ka mbyllur garat në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Karateisti Herolind Nisheviçi është mposhtur në repesazh nga serbi Slobodan Biteviçi, në kategorinë +84 kilogramë. Ndërsa karateistja Fortesa Orana (+68 kg) pësoi humbje edhe në repesazh nga kroatja Ana Marija Celan. Humbje ka pësuar edhe Alvin Karaqi, i cili u mposht në raundin e dytë nga egjiptiani Ahmed Elmasry, në kategorinë -84 kilogramë.

Paraqitje e mirë e Asllanit në shigjetari

Hazir Asllani ka fituar duelin me bashkëvendësin e tij, Atthe Luzhnica, në disiplinën hark olimpik të shigjetarisë në Lojërat Mesdhetare "Tarragona 2018". Asllani u kualifikua në 1/16 e finales, ku u përballë me favoritin Gasper Strajhar, nga i cili u mposht 6:2. Në konkurrencën e femrave, Ardita Zejnnullahu e nisi mirë përballjen me slovenen Ana Umer, duke kaluar në epërsi 2:0, por më pas humbi 6:2.

Sadiku mund t'i bashkohet Muriqit te Rizespori

Skuadra e Rizesporit ka shfaqur interesim për transferimin e sulmuesit Armando Sadiku, i cili është pjesë e Levantës. Skuadra turke po e kërkon sulmuesi shqiptar dhe në rast se arrihet marrëveshja, atëherë dyshja e sulmit në skuadrën e Rizesporit do të jetë Armando Sadiku, Vedat Muriqi.

Ronaldo: Dua të shënoj edhe katër gola

Sulmuesi Cristiano Ronaldo është i bindur se do të vazhdojë të shënojë në këtë Botëror, ku deri më tani ka shënuar katër gola, teksa ndeshja e radhës për Portugalinë do të jetë ndaj Iranit. "Ne presim të vazhdojmë më tej në Botëror, duke punuar fort dhe të kalojmë fazën e grupeve. Në pothuajse jemi të kualifikuar, por nuk mbetemi me iluzione. Po i marrim ndeshjet një e nga një dhe do të përpiqemi ta mbyllim grupin tonë në vendin e parë", ka thënë Ronaldo, duke shtuar: "Ne e dimë se një humbje ndaj Iranit do të na nxirrte nga Botërori, ndaj jemi të qetë dhe luajmë me kujdes. Edhe ndaj Marokut vuajtëm, pasi ata do të jepnin gjithçka, por ia dolëm mbanë. Unë po realizoj dhe jam i kënaqur, por nuk do të kënaqem me kaq. E di që do të shënoj sërish, pse jo edhe katër gola të tjerë".

I jepet lamtumira e fundit basketbollistit Gazmend Sinani

PRISHTINË, 24 QERSHOR - Basketbollistit të Kombëtares së Kosovës, Gazmend Sinanit, të shtunën pasdite i është dhënë lamtumira e fundit. Ylli i basketbollit të Kosovës ka ndërruar jetë në orët e hershme të mëngjesit të së shtunës si pasojë e një aksidenti rrugor që ka ndodhur në

Gjakovë. Në po të njëjtin aksident lëndime trupore kanë pësuar edhe Granit e Fisnik Rugova, Altin Morina dhe fizioterapeuti i reprezentacionit Kujtim Shala.

Gazmend Sinani ishte 27-vjeçar. Pasi kaloi grupmoshat e reja në Prishtinë, karrierën e vazhdoi në

Turqi, ku ishte pjesë e akademisë së Fenerbahçes dhe kombëtaresve turke të grupmoshave të reja. Në Kosovë ka luajtur për Prishtinën, Bashkimin e Rahovecin, kurse në klube të ndryshme turke është paraqitur disa sezone. Më 2017/18 luajti në ligën elite në

Angli. Sinani ishte anëtar i kombëtares së Kosovës që nga pranimi i FBK-së në FIBA. Me humbjen e tij, Kosova ka humbur një prej basketbollistëve më të mirë të gjeneratës, kombëtarja ka humbur njërin prej basketbollistëve më të vlefshëm dhe më luftarak.



Hamiltoni triumfon në Francë

PARIS, 24 QERSHOR - Lewis Hamiltoni ka triumfuar në Çmimin e Madh të Francës pas një dekade. Ky ishte triumfi i 65-të i anglezit. Ishte një garë pa shumë emocione, hiq startin ku pati disa makina të përplasma duke detyruar edhe makinën e sigurisë të dalë në pistë

për disa xhiro derisa të pas-trohej pista. Vetteli ishte protagonist i start tekta nuk i ka hapur rrugë Bottasit, i cili ishte më përpara në kthesë, duke e prekur me hundën e tij në gomën e majtë. Të dy pësuan dëme dhe duhet të futeshin në bokse për t'i

riparuar makinat. Pas daljes nga pista të makinës së sigurisë gara u zhvillua normalisht, me Vettelin që duhet të bënte edhe pesë sekonda penalti për gabimin ndaj Bottasit. Gjithsesi Ferrari i tij ishte shumë i shpejtë dhe ai arriti të rikuperonte shumë pozicione gjatë garës.

Hamiltoni nuk e vuri asnjëherë në diskutim fitoren, me Riccardon, Verstappenin dhe Raikkonenin që konkurronin për vendin e dytë gjatë gjithë kohës. Në fund, ishte holandezi ai që kapi vendin e dytë, me finlandezin e Ferrarit që kapi vendin e fundit të podi-



umit. Vetteli duhet të kënaqet vetëm me vendin e pestë.

Anglia luan 'tenis' ndaj Panamas, Japonia - Senegali përfundoi baras

MOSKË, 24 QERSHOR (ER) - Anglia e ka shkatërruar bindshëm Panamanë, duke siguruar kualifikimin për në fazën e 1/8-ave. Goli i parë erdhi në minutën e shtatë, me atë të qendërmbrojtësit të Manchester Cityt, John Stones. Pjesa e parë përfundoi me rezultatin e thellë 5-0, ndërsa kapiteni Harry Kane shënoi dy herë me 11-metërsh, fillimisht në minutën e 22-të, më pas në të 46-n. Mes dy penaltive të kapitenit, ishte Lingard që shënoi një supergol dhe Stones që komplotoi dyshen personale, përkatësisht në minutat e 36 dhe 40. Harry Kane mori i vetëm kryesimin e listës së golshënuesve, pasi shënoi edhe golin e tretë personal dhe të pestin në total pas dy takimesh në këtë Botëror. Nga ana tjetër, Panamaja u zgjua në minutat e fundit dhe shënoi golin e parë në pjesëmarrjen e saj të parë në një kampionat botëror, në minutën e 78 me anë të Baloyt. Ndeshja e fundit në grup do ta përcaktojë skuadrën e parë dhe të dytë.

Ndeshja e Kupës së Botës në mes të Japonisë dhe Senegalit ka përfunduar me rezultat 2-2. Senegali kaloi i pari në epërsi në minutën e 11-të. Ishte Sadio Mane që realizoi për 0-1. Japonezët u rikthyen në lojë duke e barazuar rezultatin me golin e Takashi Inui (34). Në pjesën e dytë ishte sërish Senegali që



shënoi nëpërmjet Moussa Wague (71), por Japonia e barazoi rezultatin në 2-2, autor i golit ishte Keisuke Honda (78). Pas kësaj ndeshje të dyja këto skuadra kanë grumbulluar nga katër pikë.

Sot zhvillohen katër ndeshje në Kupën e Botës

Sot (e hënë) zhvillohen katër ndeshjet e fundit në fazën e grupeve për dy grupet e para A dhe B. Në grupin e parë kualifikimin e kanë siguruar Rusia dhe Uruguai, por përballja në mes tyre do të vendosë përfundimisht skuadrën e parë dhe të dytë në Grupin A. Ndeshja tjetër në këtë grup është në mes të Arabisë Saudite dhe Egjiptit. Këto dy shtete kanë pësuar humbje në dy ndeshjet e para, kurse tash do të mundohen të përsëriten nga Botërori i Rusisë me fitore. Në Grupin B prijnë

Spanja me pikë të barabarta me Portugalinë e Cristiano Ronaldos. Spanjollët kërkojnë fitore ndaj Marokut për t'u konfirmuar si skuadra e parë e grupit, kurse portugezëve u mjafton një pikë ndaj Iranit për ta siguruar kualifikimin në 1/16 e finales.

GRUPI A	
16:00 Arabia Saudite-Egjipti	
16:00 Uruguai-Rusia	
TABELA	
1. Rusia	6 pikë
2. Uruguai	6
3. Egjipti	0
4. Arabia Saudite	0
GRUPI B	
20:00 Irani-Portugalia	
20:00 Spanja-Maroku	
TABELA	
1. Spanja	4 pikë
2. Portugalia	4
3. Irani	3
4. Maroku	0

FIFA nis hetimet për ndeshjen Zvicër - Serbi

CYRIH, 24 QERSHOR - Zvicër - Serbi është një ndeshje e destinuar të zgjasë, pavarësisht se verdikti i fushës u dha fitoren 2-1 me përmbyesje rezultati helvetëve. Festimi i Xhakës dhe Shaqirit, fjalët e trajnerit të kombëtares serbe Krstajiq si dhe koret e tifozëve ballkanas kanë detyruar FIFA-n të hapë një proces gjyqësor. Dy golshënuesit Granit Xhaka dhe Xherdan Shaqiri do të hetohen për mënyrën e festimit me shqiponjën e formuar nga duart e tyre. Festimi i tyre ka bërë jehonë të madhe në mbarë botën, ku është shpjeguar gjithçka me detaje rreth jetës së dy futbollistëve, por edhe familjes së tyre. Parashikohet që vendimi



më i mundshëm të jetë një gjobë për dy futbollistët, edhe pse do të jetë Komisioni i Disiplinës në FIFA që do të vendosë për sanksionet ndaj tyre. Me 4 pikë të grumbulluara tashmë helvetëve u nevojitet vetëm një barazim ndaj Kosta Rikës në ndeshjen e fundit në grup të mërkurën për të kaluar më tej. Në hetim ka përfunduar edhe trajneri i kombëtares serbe Mladen Krstajiq që

në përfundim të takimit u shpreh se vetëm serbët dënohen në bazë të gjykimeve selektive, më parë ishte gjykata ndërkombëtare e Agës dhe tash sistemi VAR, raporton "Supersport". Mesa duket, në festën e futbollit botëror numri një i stolit të serbëve ka bërë bashkë futbollin me gjenocidin, çka ka detyruar FIFA-n ta nisë hetimin edhe për të. Ndërkohë që në hetim kanë përfunduar edhe koret raciste të tifozëve serbë gjatë gjithë takimit, sidomos kur topi zotërohej nga futbollistët shqiptarë të Zvicrës. Ndërkohë që është përjashtuar nga çdo hetim kapiteni i skuadrës së drejtuar nga Petkoviq, Stefan Lichtsteiner.

SHKURT / "RUSI 2018"

Musa "kërcënon" Messin dhe Argjentinën

Sulmuesi kryesor i Nigerisë, Ahmed Musa, e ka "kërcënuar" Lionel Messin dhe Kombëtaren e Argjentinës, para ndeshjes së fundit në fazën e grupeve. Ai ka thënë se gjithmonë shënon ndaj kësaj kombëtare dhe ndaj Messit. "Sa herë që luaj ndaj Argjentinës dhe ndaj Messit kam shënuar gol. Para katër vjetësh, në Botërorin e zhvilluar në Brazil, realizova dy gola ndaj Argjentinës. Kur shkova te Leicesteri dhe luajtëm ndaj Barcelonës (luante edhe Messi) realizova dy gola. Ndaj gjithçka mund të ndodhë, mund të realizoj sërish dy gola. Kjo ndeshje ndaj Argjentinës është e rëndësishme për Nigerinë, pasi jemi të detyruar të fitojmë", ka deklaruar Musa, i cili realizoi dy golat e fitores në ndeshjen ndaj Islandës.

Kroosi: Na donin të eliminuar, kishte edhe gjermanë

Toni Kroos e shënoi golin e fitores për Gjermaninë në ndeshjen ndaj Suedisë (2-1). Ai pas ndeshjes befasoi duke thënë se shumë e donin Gjermaninë të eliminuar, mes tyre, sipas Kroosit, kishte edhe gjermanë. "Ja arritëm të fitonim një ndeshje që duhej ta fitonim patjetër. Ishin të shumë njerëzit që donin që ne të eliminoheshim para kohe, madje edhe gjermanë, por nuk do t'ia bëjmë aq të lehtë. E meritam këtë fitore, ushtruar shumë presion, edhe pse nuk krijuam shumë. Në fund na mjaftoi për të fituar. Tani nuk kemi kohë për të pushuar dhe duhet të përgatitemi për ndeshjen ndaj Koresë që na duhet ta fitojmë patjetër", u shpreh Kroosi.

Hazardi: Synojmë finalen e Botërorit

Eden Hazard ka bërë me dije se Belgjika synon të kualifikohet deri në finale të Kupës së Botës "Rusi 2018". "Ka qenë e lehtë për ne ndeshja ndaj Tunizisë. Mendoj se jemi një skuadër e mirë dhe duam finalen. Katër vjet më parë kemi humbur me Argjentinën, por tani gjërat kanë ndryshuar dhe jemi më të fortë", ka thënë Hazard, i cili e ka lavdëruar edhe sulmuesin Romeo Lukaku: "Lukaku është një djalosh që meriton gjithçka. Stërvitet për t'u fuqizuar dhe shënon shumë. Luajmë shumë mirë bashkë. Kur ia pasojmë topin para portës, ai nuk gabon. Është në formë shumë të mirë dhe do të vazhdojë të shënojë".

Costa humbet ndeshjen ndaj Serbisë

Futbollisti Douglas Costa ka pësuar një lëndim muskolor në stërvitje dhe do të mungojë në ndeshjen e fundit ndaj Serbisë. Costa ka luajtur në ndeshjen ndaj Kosta Rikës në pjesën e dytë, kurse është pritur të luajë edhe në ndeshjen e fundit të grupit, e cila do ta vendosë fatin e Brazilit në këtë Botëror. Ndeshja Serbi - Brazil zhvillohet të mërkurën nga ora 20:00.

Linekeri përditëson shprehjen: Në fund, gjithmonë fitojnë gjermanët

Ish-lojtari i Kombëtares së Anglisë, Gary Lineker, ka komentuar sërish fitoren mbresëlënëse të Gjermanisë, me përmbyesje rezultati 2-1 ndaj Suedisë, duke përditësuar edhe shprehjen e tij të famshme për "Mannschaft"-in. Ish-fantazisti i Tottenhamit dhe Barcelonës, njihet gjerësisht edhe për një prej shprehjeve më të veçanta në botën e futbollit. "Futbolli është një sport i shpikur nga anglezët. Aty luhet 11 kundër 11, por në fund fitojnë gjithmonë gjermanët", do të thoshte ai pasi humbi ndaj Gjermanisë në gjysmëfinalen e Botërorit "Itali 1990".



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
 VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
 GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
 Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
 (AKPPM)

Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
 Kosova Medicines Agency (KMA)



Duke u bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, **Agjencia e Kosoves per Produkte dhe Pajisje Medicinale** shpall këtë:

KONKURS

1.Titulli i punës : Një (1) Zyrtar Ligjor
Referenca : 03/2018
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-s
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave profesionale në fushën e hartimit të politikave dhe legjisllacionit nga fushëveprimi i institucionit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Hartoni Vendimet lidhur me qarkulluesit farmaceutik me pakicë dhe shumicë, në rastet e mos respektimit të afateve ligjore për pagimin e takses vjetore
- Bashkëpunoni me Avokaturën Shtetërore, lidhur me lëndët gjyqësore të AKPPM-së.
- Hartoni akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjisllacionit në fuqi.
- Siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjisllacionin në fuqi në Kosovë.
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare.
- Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim.
- Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera.
- Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjisllacionit.
- Kryen edhe punë tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.
- Kryen dhe punë të tjera në pajtim me qëllimin e vendit të punës të cilat mund të kërkojnë nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Kualifikimi

Diplomë universitare, minimum 2 vite përvojë pune profesionale

Shkathësitë

Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën e legjisllacionit dhe hartimin e akteve ligjore
 Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
 Shkathësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ
 Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale
 Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access)

2.Titulli i punës : Një (1) Zyrtar/e për Kontrollimin e Përkthimeve
Referenca : 03/2018
Lloji i pozitës : Marrëveshje mbi shërbimet e veçanta deri në (6) muaj
Orari i punës : 40 orë në javë
Mbikëqyrësi : Kryeshefi Ekzekutiv i AKPPM-së
Vendi : AKPPM-Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Ndihmon departamentin e AutorizimMarketingut në permbushjen e afateve ligjore në lidhje me kontrollimin e përkthimeve në dosjet e AM-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kontrollimi fletëudhëzimet për pacient.
- Përputhshmëria sipas formës zyrtare të AKPPM-së.
- Përkthimi profesional.
- Përputhshmëria e të dhënave me dokumentacionin e dorëzuar.
- Kontrollimi i përmbledhjeve dhe karakteristikave të produktit.
- Kontrollimi i paketimit të jashtëm.
- Kontrollimi i paketimit të brendshëm (Mock-up).
- Detyra tjera sipas kërkesës së drejtorit të AM-së dhe Kërkesës së Kryeshefit Ekzekutiv në lidhje me qëllimin e vendit të punës.

Kualifikimi

DU+2 vite përvojë pune

Shkathësitë

Njohja e gjuhëve zyrtare.
 Njohuri dhe përvojë substanciale.
 Aftësi komunikuese, negociuese.
 Shkathësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë.
 Shkathësi në organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një grup pune.
 Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Formulari për aplikim mund të merret në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, Zyra e Personelit, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Prishtinë), ku edhe dorëzohen pas plotësimit. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni me Zyrën e Personelit në numrin e telefonit: **038/20024243** prej orës **08:00-16:00**.

Formulari zyrtar i konkurrencës duhet të dorëzohet së bashku me dëshminë për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, përvojën e punës, çertifikatën (dëshminë) që s'është nën hetime dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjithë komunitetet e Republikës së Kosovës”.

“Komuniteti jo – shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Kandidatët të cilët hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (prej datës: 25.06.2018 deri më datën: 02.07.2018 në ora 16:00).



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS/MINISTRIA E SHËNDETËSISË
 VLADA KOSOVA/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA
 GOVERNMENT OF KOSOVA/MINISTRY OF HEALTH
 Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Paisje Medicinale
 (AKPPM)
 Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva (KALMS)
 Kosova Medicines Agency (KMA)



Na osnovu Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova, br. 03/L-149 i Uredbe br.02/2010 za procedure zapošljavanja u civilnoj službi Republike Kosova, **Kosovska Agencija za Lekove i Medicinska Sredstva** objavljuje:

KONKURS

1. Naziv radnog mesta: 1 (jedan) Pravni službenik

Referenca : 03/2018
Vrsta pozicije : Sporazum o posebnim uslugama do (6) meseci
Radno vreme : 40 sati nedeljno
Nadzornik : Izvšni Direktor
Mesto : KALMS-Priština

Svrha radnog mesta:

Pružanje usluga i stručnih saveta u oblasti izrade politika i zakonodavstva iz delokruga institucije.

Zadaci i odgovornosti:

1. Sastavlja odluke u vezi sa farmaceutskim prodavacima na veliko i malo, u slučajevima nepoštovanja zakonskih rokova za plaćanje godišnje tarife.
2. Saraduje sa Državnim Advokatom u vezi sa sudskim predmetima KAMPO-a.
3. Izrađuje normativne akte, kao i druge pravne akte koji proizilaze iz oblasti delatnosti institucije u skladu sa postupcima utvrđenim zakonom na snazi.
4. Osigurava usklađenost nacrt zakona i drugih pod-zakonskih akata sa zakonima na snazi na Kosovu.
5. Stara se da je sadržaj i oblik normativnog akta što precizniji, kako iz jezičkog, tako i iz tehničkog aspekta, kao i da budu identični na sva tri službena jezika.
6. Sprovodi istraživanje i analizu informacija o temama određenim od strane nadzornika i prepoznaje mogućnosti i pitanja za razmatranje.
7. Na zahtev i prema instrukcijama na najvišem nivou daje pravna mišljenja i izrađuje nacрте sporazuma, nacрте rešenja i drugih projekt aktova.
8. Saraduje i komunicira sa drugim jedinicama, unutar i van institucije za aktivnosti koje se odnose na oblast zakonodavstva.
9. Obavlja i druge poslove u skladu sa svrhom radnog mesta koje se mogu tražiti u vremena na vreme od strane nadzornika.
10. Obavlja i druge poslove u skladu sa svrhom posla koji može zahtevati izvršni načelnik KAMPO-a.

Kvalifikacije:

Univerzitetska diploma, najmanje 2 godine radnog iskustva u struci.

Veštine:

Dobro i specijalizovano znanje u oblasti zakonodavstva i izradi zakonskih akata
 Poznavanje primenjivih zakona i propisa
 Komunikacione veštine u planiranju rada, eventualna koordinacija osoblja na administrativnom nivou
 Istraživačke, analitičke veštine, procena i formulacija preporuka i stručnih saveta
 Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access)

2. Naziv radnog mesta: Jedan (1) Službenika/ca za Kontrolu Prevoda
Referenca : 03/2018
Vrsta pozicije : Sporazum o posebnim uslugama do (6) meseci
Radno vreme : 40 sati nedeljno
Nadzornik : Izvšni Direktor
Mesto : KALMS-Priština

Svrha radnog mesta:

Pomaže odeljenje Marketing Autorizacije u ispunjavanju zakonskih rokova u vezi sa kontrolom prevoditelja u AM zapisnik

Zadaci i odgovornosti:

1. Kontrola upustva za pacijenta
2. Uskladenost prema službenom obrascu KALMS-a
3. Profesionalni prevod
4. Uskladenost podataka s dostavljenim dokumentacijom
5. Kontrola kompozicije i karakteristike proizvoda
6. Kontrola pakovanja
7. Kontrola unutrašnjeg pakovanja (Mock-up)
8. Ostale dužnosti koje je zatražio Direktor Marketing Autorizacije i zahtjev glavnog Izvršnog Direktora vezane za svrhe posla.

Kvalifikacije

DU+2 godine radnog iskustva.

Veštine

Znanje službenih jezika.
 Znanje i osnovno iskustvo.
 Veštine komuniciranja i pregovaranja.
 Veštine u određivanju ciljeva, radnog planiranja i analize.
 Veštine za timsko organizovanje, sposobnost da upravlja sa jednim ili više radnih grupa.
 Računarske veštine sa softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access).

Uzimanje i podnošenje aplikacija:

Obrazac za aplikaciju može se dobiti u Kosovskoj Agenciji za Lekove i Medicinska Sredstva, Kancelarija ljudskih resursi, (Adresa: Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000, Priština), gde mogu se dostaviti nakon popunjavanja obrazaca. Za detaljnije informacije, možete kontaktirati Kancelariju ljudskih resursa u broj telefona: **038/20024243** od **08:00-16:00**.

Službeni obrazac za konkurisanje treba da se dostavi zajedno sa dokazom o školskoj kvalifikaciji, završenim tečajevima, radnim iskustvom, sertifikatom (dokaz) da nije pod istragom i dve referencije. Upotreba pogrešnog i nekompletiranog obrazaca sa potrebnim podacima smatraće se nevažećim.

“Civilna Služba Republike Kosove pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i dočekuje aplikacije od muškaraca i žena od svih zajednica Republike Kosova”.

“Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo da budu predstavljeni pravedno i proporcionalno u organima civilne službe Javne Administracije na lokalnom i centralnom nivou, kao što je naznačeno u čl.11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova”.

Aplikacije poslate poštom, koja nose poštanski žig na pošiljci na poslednji dan roka za podnošenje aplikacije, smatrati će se važećim i biće uzete u obzir ako stigne u roku od 3 dana. Prijave koje pristignu nakon tog roka neće biti razmatrane uopšte.

Kandidati koji budu ušli u uži izbor za intervju biće obavesteni pismenim putem ili preko telefona u zakonskom roku od strane osoblja.

Rok za konkurs je otvoren 08 dana od dana objavljivanja u novinama (od datuma: 25.06.2018 do datuma: 02.07.2018 u 16:00).

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI EKONOMIK

NJOFTIM

Në mbledhjen e Senatit të Universiteti të Prishtinës "Hasan Prishtina" të datës 18.06.2018, u ratifikua vendimi i Këshillit të Fakultetit Ekonomik nr.01/644, i datës 01.06.2018, lidhur me vlerësimin e raportit mbi punimin e doktoratës: Ndikimi i ndryshimit të normës së TVSH-së në buxhet dhe në zhvillimin ekonomik të Kosovës, të kandidatit Bashkim Mustafa.

Njoftohen të gjithë të interesuar, së me datë 04.07.2018 ora 11:00 në Fakultetin Ekonomik (Amfiteatri i vogël), kandidati Bashkim Mustafa i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës.

Me mentor Prof. Asoc. Dr. Drita Konxheli para komisionit profesional në përberje: Prof. Dr. Ajet Ahmeti – kryetar, Prof. Dr. Myrvete Badivuku – anëtar dhe Akademik. Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti, anëtar i jashtëm

Prishtinë, 2018

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Kushtim Ademqaj shpallë të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Abdyl Frashëri" Prizren.
- ▶ Lëshoj me qira banesën në Prishtinë, Lagja Mati 1, rr. Ndue Perllashi (pas 13 katshes). Banesa ka 58 m. katrorë, e mobiluar. Nr. kontaktues 044-121-668 ose 044-172-938. Çmimi sipas marrëveshjes.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155
- ▶ Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.
- ▶ Urgjentisht kërkohet banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe deponitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958
- ▶ Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, truall frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.
- ▶ Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.
- ▶ Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783
- ▶ Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





TrafikuUrban

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1,5 dhe 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien në Punë, Vendimi nr. _____ të datës _____
Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.K. "Trafiku Urban" S.H.A, Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

1. Inxhinier i mekanikes (1 vend pune)
2. Monitorues i kamerave dhe GPS-ve (1 vend pune)
3. Auto-mekanik i autobusëve (2 vend pune)
4. Auto-elektricitist i autobusëve (1 vend pune)
5. Auto-llamarist (auto-ngjyrosës) (1 vend pune)

Pozita 1. Inxhinier i mekanikes

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq ekipin e mirëmbajtjes për kontrollin e autobusëve gjatë ndërrimit të tretë (3^{-e}) dhe organizon riparimet e nevojshme që autobusët të jenë të gatshëm për operim në mëngjes.
- Përgatitë, vlerëson, kontrollon, bën analiza të punës për ngjarje të efikasitetit dhe cakton orarin e punës në Sektorin e Mirëmbajtjes.
- Jep udhëzime dhe mbanë përgjegjësi në mirëmbajtje të autobusëve, për punën që duhet të kryhet brenda orarit të punës.
- Përgatitë raportet ditore për punët e kryera dhe planifikon punët të cilat duhen të kryhen në mirëmbajtje të autobusëve, ardhjen e punëtorëve në punë, problemet e paraqitura në orar të punës, kërkesat dhe nevojat e pjesëve nga depoja për nevojat e mirëmbajtjes si dhe menaxhon depon me pjesë rezervë.
- Identifikon problemet e funksionale të autobusëve përmes diagnostifikimit kompjuterik dhe organizon riparimin me ekipin e mirëmbajtjes.
- Mbikëqyrë dhe kërkon përgjegjësi prej udhëheqësve të ndërrimit dhe para punëtorëve për punën që kanë kryer dhe të cilën duhet ta kryejnë.
- Mbanë evidence për çdo autobus për gjendjen teknike të tyre, regjistrimin e aksidenteve dhe vlerësimin e dëmeve të krijuara, administron procedurat për çdo autobus.
- Raporton tek Udhëheqësi i Mirëmbajtjes me shkrim për defektet të cilat janë paraqitur, shkaku dhe dëmtimet e autobusëve, apo i automjeteve tjera motorike të TU, ose sipas nevojës raporton drejtpërdrejt tek Menaxheri i Operativës.
- Është përgjegjës për gjendjen teknike të autobusëve dhe automjeteve tjera, përcjellë pasqyrat mujore të harxhimeve të vajrave dhe karburanteve, të pjesëve rezervë, gomave dhe regjistrimin e kilometrave të kaluara.
- Bën planifikimin e porosive për pjesë rezervë për nevojat e autobusëve.
- Në raste të aksidenteve të autobusëve në komunikacion, është i obliguar që t'i regjistrojë dhe të vlerësojë dëmet e krijuar, përgatitë raport të aksidentit duke i regjistruar defektet në formë procedurale me foto, etj.
- Mbledhë, analizon dhe vlerëson të dhënat e mirëmbajtjes dhe i ofron shënimet profesionale për Udhëheqësin e Mirëmbajtjes.

Detyrat dhe obligimet tjera shtesë

- Menaxheri i Operativës mund ta ngarkojë me detyra tjera shtesë sipas nevojës dhe specifikave në TU: dalja në teren në rast të aksidenteve, intervenim të shpejtë në rast të defekteve në teren për ta identifikuar defektin dhe organizuar riparimin apo për ta organizuar largimin e autobusit nga rruga.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Të ketë diplomë nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike në njërin nga drejtimet: Prodhimtar, Konstrukcione apo Termo-energetikë. Diplomë Bachelor apo me përparësi është diploma Master i Shkencave Teknike.
- Njohuri dhe profesionalizëm dhe qasje moderne me ide, hulumtim, planifikim dhe kontroll të automjeteve.
- Aftësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet kompjuterike në fushën e teknikës.
- Të jetë ambicioz për të mësuar dhe hulumtuar në fushën e automjeteve (motorët me djegie të brendshme).
- Gatishmëri për të punuar natën, sepse është çështje specifike mirëmbajtja e autobusëve gjatë ndërrimit të 3-të.
- Përvoja e punës në fushën e automjeteve është përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze është obligative.
- Njohja e gjuhës serbo-kroate është përparësi.

Pozita 2. Monitorues i kamerave dhe GPS-ve

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 1 vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitoron, kontrollon dhe mirëmban kamerat dhe GPS-at në autobusë.
- Bën regjistrimin dhe identifikimin e problemeve të cilat paraqiten në inçizimet e kamerave dhe GPS-ve,
- I nxjerrë raportet, problemet të cilat paraqiten gjatë orarit të operimit dhe i ruan ato nga kamera dhe GPS.
- Mbanë statistikën lidhur me performancat e autobusëve, nxjerrë raportet e harxhimeve të derivateve, aksidenteve, shpejtësisë së autobusëve, keqpërdorimeve të mundshme, të hyrat dhe zhvillimet nëpër autobusë gjatë punës.
- Kujdeset për servisim dhe mirëmbajtje të kamerat dhe GPS-ve.
- Mbanë librin e evidencës të nisjes dhe ardhjes së autobusëve nga linjat e operimit, pranon defektet dhe problemet të cilat janë paraqitur në autobus.
- Për çdo problem i cili ndodhet në operim paraqitet si rast dhe e bën regjistrimin dhe informacionin e shpërndan, duke e nxjerrë nga kamerat dhe GPS-at.
- Mbanë evidencën e intervenimeve e nevojshme të autobusëve dhe pastaj kontakton Menaxherin Operativës dhe e njofton lidhur me problemin.
- Kontakton me dispečerët me qëllim të marrjes së masave të caktuara dhe ofrimin e ndihmës për operim të rregullt të autobusit.
- Mbledhë, ofron dhe analizon dhe vlerëson të dhënat e transportit me linjat e operimit përmes kamerave dhe GPS-ve.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i lartë TIK, Menaxhment dhe Informatikë ose të ngjashme nga fushat teknike.
- Njohuri të qasjeve moderne në planifikim dhe kontroll,
- Aftësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet kompjuterike me kamera dhe GPS.
- Njohja e gjuhës angleze është obligative.
- Njohja e gjuhës serbo-kroate është me përparësi.
- Përvojë pune duhet të ketë së paku 3 vjet.
- Gatishmëri për të punuar natën sepse është specifike mirëmbajtja e autobusëve gjatë ndërrimit të 3-të.
- I gatshëm për të dalë në teren, gjatë operimit të autobusëve sipas nevojës dhe rasteve.

Pozita 3. Automekanik i autobusëve

Numri i pozitave: 2 (dy)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pas pranimit të detyrave nga eprori/inxhinieri i mekanikes, duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin e autobusëve që janë në pritje për riparim duke u bazuar në urdhëresat të punës.
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranim – dorëzimit.
- Sipas udhëzimeve nga inxhinieri përgjegjës, fillon riparimin apo ndërrimin e pjesëve dhe merr pjesë të drejtpërdrejt në identifikim të defektit të autobusit, të gjitha punët e kryera duhen të përcillen me procedurë përkatëse,
- Është përgjegjës për riparim të shpejtë dhe profesional të autobusit me udhëzime të marra nga inxhinieri ose eksperti teknik.
- Kontrollon gjendjen dhe është përgjegjës për pastërti në hapësirën punuese.
- Regjistron harxhimin e materialit dhe pjesëve rezervë dhe është përgjegjës për arsyeshmërinë e montimit e çdo pjesë.
- Jep përgjegjësi dhe llogari për punë e kryer dhe duhet të jetë i disiplinuar në punë duke respektuar rregulloret.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i lartë ose i mesëm në drejtimin e makinerisë.
- Njohuri të punës profesionale dhe i motivuar për punë.
- Përvoja e punës është me përparësi.
- Gatishmëri për të punuar natën sepse është specifike mirëmbajtja e autobusëve gjatë ndërrimit të 3-të.
- I gatshëm për të dalë në teren në rast të defekteve në autobus sipas nevojës dhe rasteve.

Pozita 4. Auto-elektricitist i autobusëve

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pas pranimit të detyrave nga eprori/inxhinieri ose eksperti teknik, duhet të angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin e autobusëve me defekte të elektrikes, që janë në pritje për riparim duke u bazuar në urdhëresat për punë.
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranim – dorëzimit.
- Bashkë me inxhinierin përgjegjës e identifikon problemin e elektrikes së autobusit, të gjitha punët e kryera duhen të përcillen me procedurë përkatëse.
- Është përgjegjës për riparim të shpejtë dhe profesional të defekteve në lëmi të elektrikes në automjete.
- Kontrollon gjendjen në hapësirën e punës dhe është përgjegjës për pastërti në vendin e punës.
- Jep përgjegjësi dhe llogari për punë e kryer dhe duhet të jetë i disiplinuar në punë duke respektuar rregulloret e ndërmarrjes.
- Mbanë evidencën për çdo autobus që e ka riparuar, defektet dhe pjesët e montuara.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollim i lartë ose i mesëm në drejtimin për auto-elektricitist.
- Përvoja e punës si elektricitist në riparim të automjeteve është përparësi.
- Gatishmëri për të punuar natën sepse është specifike mirëmbajtja e autobusëve gjatë ndërrimit të 3-të.
- I gatshëm për të dalë në teren në rast të defekteve në autobus sipas nevojës dhe rasteve.
- Ambicioz për të marrë njohuri të reja në lëmi të automjeteve.

Pozita 5. Auto-llamarist (ngjyrosës)

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e punës: 3 vite me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pas pranimit të detyrave nga eprori/inxhinieri, angazhohen në kryerjen e detyrave për riparimin dhe ngjyrosjen e autobusëve nga aksidentet e krijuar dhe kthimin e gjendjes së mëparshme.
- Bën riparimin e llamarinës së autobusëve dhe përgatitjen për ngjyrosje.
- Të jetë i aftë dhe me përvojë për saldimit të llamarinave dhe konstrukcionit të autobusëve,
- Ngarkohet me pjesë dhe vegla pune, të cilat i ka kërkuar nga depoja si dhe pajisje të tjera, duke respektuar procedurat e pranim – dorëzimit.
- Është përgjegjës për riparim dhe me ngjyrosje të shpejtë dhe profesional të autobusëve.
- Kontrollon gjendjen dhe është përgjegjës për pastërti në vendin e punës.

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Shkollimi i mesëm në drejtimin auto-llamarist.
- Përvojë pune (me përparësi mbi 3 vite).
- Me përparësi përvoja e saldimit me disa metoda të saldimit.
- Gatishmëri për të punuar natën gjatë ndërrimit të 3-të në raste specifike për riparim të autobusëve.

Dokumentacioni i nevojshëm dhe mënyra e aplikimit:

Kandidatët që aplikojnë për pozitën 1 dhe 2 duhet t'i dorëzojnë këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU) <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>
2. Letër motivuese.
3. Kopja e letërnjoftimit.

Kandidatët që aplikojnë për pozitën 3, 4 dhe 5 aplikacionet e tyre mund t'i sjellin edhe në kopje fizike në zyrë të N.P.K. "Trafiku Urban" S.H.A, rr. Tahir Zajmi p.n. Prishtinë.

1. Aplikacionin për punësim (e marrin fizikisht në zyrë të N.P.K. "Trafiku Urban").
2. Kopje të diplomës.
3. Kopje të letërnjoftimit

Kandidatët të cilët kalojnë në fazën e intervistës duhet t'i dëshmojnë të dhënat e paraqitura në aplikacion në kopje fizike.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.
Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit (25.06.2018 deri më 09.06.2018).

Vërcjtye: Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Numri i kontaktit për konkursin është: **045/10 11 22** nga ora 08.00 deri 16.0 (e hënë – e premte)

Data:
25.06.2018

Kryeshefi Ekzekutiv
Tulzim Rexhepaj



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA “RITMO – L”

**Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333